

Jeanne Cordelier

KAMILA E ENGJËJVE

Dramë në katër akte

E përktheu nga origjinali:

Fatos Kongoli

Tiranë, 2003

© Originali: Camille des Anges, Jeanne Cordelier, 1987
© Traduction en Albanais, Fatos Kongoli, 2003

VETAT

Zonja Helmirë, rreth 50 vjeç, zezake me origjinë nga Martinika.

Argjendari, pronar i Kafesë së Madhe.

Kamila, 23 vjeç, prostitutë.

Gruaja Leopard, ajo mban veshur një manto dhe një kapele prej lëkure pantere, me anë të gjera.

Djaloshi, i papunë.

Kamerieri, rreth dyzet vjeç, ish-endacak.

VENDET

Një dhomë mjaft e madhe, me mure në ngjyrë të vërdheme, vende – vende me fulltaka dhe e skërfitur. Një dysHEME me pllaka, verdhë e bardhë. Një derë që hapet nga ana e nevojtores, me mure tërë zhgarravina. Një derë tjetër, e mbyllur, mbi të cilën shënohet: Me defekt (*shkruar me dorë mbi një copë kartoni*). Dy kabina telefonike, që mbajnë numrat 1 dhe 2. Një musandër teneqeje, e lartë dhe e ngushtë. Një mbajtëse pecetash, ku varet një leckë me bardhësi të dyshimtë. Një tryezë dhe një karrige. Mbi shpinoren e karriges, një mushama ngjyrë vjollcë prej lënde plastike. Një central telefonik i vendosur në mur, pranë tryezës. Dhoma ndriçohet nga një llampë neoni. Në dhomë zbret një shkallë spirale, nga e cila shihen vetëm pesë shkallaret e para.

TEKSTET

Tekstet që këndohen ose recitohen janë të **Gaston Couté**-së, të nxjerra nga:

“Fëmija i humbur i revoltës”

“Trubaduri plak”

“Kariatidet e Rotondës”

AKTI I PARË

Zonja Helmirë është në këmbë, mbi ndenjësen e nevojtores, me shpinë të kthyer nga salla.

ZONJA HELMIRË: Duket si gjak ... Po pse të çuditem kur ka që i shkruajnë dermitë e tyre me të pëgëra. (*fërkon*) Nuk shqitet. Të jetë manikyr? Ah, dembelet, që gjejnë kohë t'i katranosin majat e gishtave me këtë. Mirëpo syrit tim nuk i shpëtojnë dot, sapo fillojnë të sillen si zonja të rënda. Të vjen tjetra e pispillosur, tërë parfum, ngjyer e zhgërryer. Por kur mbetesh prapa tyre, ha! Kur mbetesh prapa, atëherë më fal! Zonjat e rënda t'i flakin ato leckurinat përtokë!

Hyn një burrë që shkon drejt e në nevojtores.

ZONJA HELMIRË: E njoha hapin tuaj, zoti Bert.

ARGJENDARI: (*duke zbërthyer pantallonat*) Mos u merakos për mua, vazhdo punën.

ZONJA HELMIRË: Ca derra vijnë e t'i bëjnë këto pisllëqe sipër fare, mbi rezervuar...do të kisha më shumë nevojë për një fron se sa për doreza kauçuku. Kurrë s'kam mundur t'i mbaj dorezat...Jo, jo, te ne ia linin ca pipiruve, që kishin kohë të merreshin me duart e tyre.

ARGJENDARI: Ah, o Zot, sa të qetëson kjo!

ZONJA HELMIRË: A kuptoni ndonjë gjë në këtë mes ju, zoti Bert?

ARGJENDARI: (*duke u tundur*) Çfarë moj zemër?

ZONJA HELMIRË: Në fillim kujtova se ajo që shkruhej atje më drejtohej mua personalisht: u zemërova vërtet.

ARGJENDARI: Pse, çfarë shkruhej?

ZONJA HELMIRË: (*duke lënë sukllin të rrëshqasë përgjatë tubit të ujit*). Në mungesë të asaj plaçkës së bardhë, kërko pluhur larës për të fërkuar haletë...Telefono: 09003542

ARGJENDARI: Nuk shoh gjë.

ZONJA HELMIRË: Po vizatimin në tavan dje, nuk jua zunë sytë?

ARGJENDARI: *(duke u mbërthyer)* Jo, por duhet thënë se unë nuk shoh kurrë në hava... Mirë, pra, ma trego!

ZONJA HELMIRË: *(me kokën të rrëzuar prapa)* Është e çuditshme...I ngjan një këpurdhe dhe një instrumenti muzikor, që nuk ia di emrin.

ARGJENDARI: *(duke u drejtuar nga salla)* Trompë me piston, natyrisht. U ngjan koqeve të paturpshme dhe trompës me piston, e kjo, zemra,do të quhej pallosh: një pallosh!

Ai ecën nëpër dhomë me nervozizëm, me duar të lidhura pas shpine.

ZONJA HELMIRË: A do t'u thoni ndonjë ditë të vendosin këtu një kapak? Para se të thyej ndonjë këmbë. Po hidraulikët, kur do të vijnë hidraulikët?

ARGJENDARI: Kurrë! Unë kërkoj të krijoj këtu një atmosferë, këtë dua unë...por ju s'do ta kuptoni. Askush s'do ta kuptojë.

ZONJA HELMIRË: Ndoshta kjo mund të fshihet me ndonjë tretës. Zoti Bert, ju lutem,kini mirësinë të më jepni pak shishen e tretësit, që ndodhet në musandër,dhe një leckë të thatë.

ARGJENDARI: *(duke hapur musandrën)* Cilën shishe? Këtu ka një vagon me shishe *(ai e mbyll vrazhdësisht derën e musandrës)*. Pastaj, jo! Nuk do të na e prishësh atmosferën me këtë ndyrësi. Mua më bie bretku t'i bëj punët në një mënyrë që...Ndërsa ajo vjen e ta prish menjëherë me pastërtinë e saj të sëmurë. A nuk mund të kënaqesh ti duke u paguar pa bërë asgjë? Dua të të shoh vetëm ulur pas kësaj tryeze... *(ai qëllon mbi tryezë me shputën e dorës)*... dëgjon? Dhe nëse tash e tutje zhduket një zhgarravinë, ti do të zhdukesh bashkë me të, qartë?

ZONJA HELMIRË: *(duke tërhequr galexhantin)* Letër të butë s'ka më, e kanë zëvendësuar me letër gazete...

Pushim.

ARGJENDARI: Sot, pasi mbylla dyqanin, ajo nuk u duk...Mos e ke parë gjë?

ZONJA HELMIRË: Jo, ende s'e kam parë.

ARGJENDARI: Ty, që do ta mbyllësh jetën në padituri, ndoshta të duket qesharake, apo jo, të dashurohesh pa qënë i shpërblyer me të njëjtën monedhë.

ZONJA HELMIRË: Po ju nuk e dashuroni atë, zoti Bert, puna është se ju e doni të gjithën për vete.

ARGJENDARI: *(duke dalë nga dhoma)* Ç'merrem dhe unë me të!

Pushim.

ZONJA HELMIRË: *(duke fërkuar përsëri rezervuarin)* Nuk doli gjë. Sot ai duhej të më kishte lënë një kartëmonedhë...

Dëgjojen përplasje takash nëpër shkallë dhe Kamila hyn duke kënduar.

KAMILA: Më dashuronin... Isha e adhuruar
Sepse kisha gjithçka për t'u pëlqyer:
Vështrimin shpuzë dhe provokues
Më dashuronin... Isha e adhuruar.

ZONJA HELMIRË: Bukuroshja ime, më thuaj shpejt, çfarë kartëmonedhe më ka lënë ai?

KAMILA: Perveç monedhës së ngjitur me mastiç në fundin e pjatëzës, aty nuk ka asgjë.

ZONJA HELMIRË: Pse nuk thua që paskam ngrënë dynjanë kot?

KAMILA: Kështu do të mësosh se si të tregohesh më e zonja për të marrë atë që të takon.

ZONJA HELMIRË: Më duket po tallesh Kamilë...më thuaj, mos i more ti paratë?

KAMILA: Unë? Epo kjo! Se mos rroj me lëmosha unë...Por dëgjomë, Helmirë, kërkoj një nder prej teje: më duhet të fsheh një plaçkë deri nesër. Dhe mendova se rezervuari i ujit do të ishte një skutë e mirë...

ZONJA HELMIRË: *(duke zbritur nga ndenjësja)* Atëherë pasi të lë punën... sepse përse kohë jam përgjegjëse e nevojtores...

KAMILA: Përgjegjëse e nevojtores!

ZONJA HELMIRË: *(duke u ulur pas tryezës)* Oh, mos u mbaj me të madh. Nuk do të jesh gjithë jetën njëzet vjeçe!

Kamila ulet mbi tryezë.

KAMILA: *(këndon)* Dhe gjithmonë kisha kujtuar
Se jetohej vetëm me dashuri të papërlyer
Më dashuronin...Isha e adhuruar.

ZONJA HELMIRË: Meqë po këndon, s' është nevoja të të pyes nëse ke kaluar një mbrëmje të bukur...

KAMILA: *(duke e hapur çantën krejt)* Dhe mbrëmja nuk ka mbaruar ende!

ZONJA HELMIRË: *(me sy të zgurdulluar)* E pafe! Ç'pare të madhe paske bërë sonte! Dhe sa burra për këto?

KAMILA: Një!

ZONJA HELMIRË: Gënjeshhtarja! Mund t'i numërosh ata që ka kaluar sonte siç po palos kartëmonedhat... Pesëmbëdhjetë, për të mos thënë njëzet... Ah, gënjeshhtarja e vockël!

KAMILA: *(duke mbvllur çantën)* Vetëm një po të them! Mjafton të mbyllësh sytë. *(pushim)* E lashë në tako B-në, s'i vajta në takim, ndizet më fort kështu.

Dëgjohen hapa nëper shkallë.

ZONJA HELMIRË: Kujto qenin...

Kamila vrapon të mbyllet në kabinën telefonike numër 2.

ARGJENDARI: *(duke i zbritur shkallinat e fundit me vrull)* E pashë që kaloi, e pashë në tavan!

ZONJA HELMIRË: *(duke nxjerrë nga sirtari një triko)* Në tavan?

ARGJENDARI: *(duke u kthyer nga salla)* Ka nëntë vjet që çdo ditë, ose thuajse çdo ditë, në orën dhjetë, kur mbërrij te Kafja e Madhe, e gjej të ulur në të njëjtën tryezë përballë arkës, duke ngrënë e babëzitur sanduçin e saj të perjetshëm me sallam dhe kastravecë! Ka nëntë vjet që shoh shfaqjen e zvergut të saj të dhjamur, të përkulur mbi pjatë. Nëntë vjet që është punësuar te Kafja e Madhe për të mos bërë asgjë... Megjithatë nuk e ka vënë re kurrë se tavani është prej pasqyre!...Ku është ajo?

ZONJA HELMIRË: Mbase e keni gabim...zoti Bert, pa dashur t'ju kundërshtoj... por më duket se e harruat atë punën time të vogël të para pak çasteve...

ARGJENDARI: Unë nuk kam harruar asgjë: ti po merr ca zakone të këqija.

Kamila del nga kabina telefonike duke kënduar.

KAMILA: Vështrim shpuzë dhe provokues

Më dashuronin, ...Isha e adhuruar...

ARGJENDARI: Isha i sigurt!

ZONJA HELMIRË: Duhet të ketë kaluar pa më rënë në sy...

KAMILA: Unë ekzistoj!

ARGJENDARI: Të prita deri në orën tetë e gjysmë.

KAMILA: Isha e zënë.

ARGJENDARI: Varet nga ti që të mos jesh më e zënë...

KAMILA: Zonja Helmirë, nëse në moshën njëzet vjeçe...

ARGJENDARI: Mos gënje, të kam parë patentën e makinës.

KAMILA: Nëse në moshën njëzet e tre vjeçe, një burrë tridhjetë e nëntë vjet më i madh se ti do të të kishte ftuar të futeshe në një kafaz të praruar, çfarë do të kishe bërë?

ZONJA HELMIRË: Do t'ia kisha thënë copë: nuk pranoj!

KAMILA: *(duke iu drejtuar argjendarit)* E sheh?

ARGJENDARI: Oh, ç'ke me të!

ZONJA HELMIRË: Oh, ç'ke me mua, ç'ke me mua! Sikur të mos ndodhem këtu për të kënaqur çdo ditë veset tuaja të vogla...

KAMILA: Për më tepër ka edhe vese!

ARGJENDARI: Çfarë për më tepër? Ç'do të thotë kjo?

ZONJA HELMIRË: Se do të duhet zmadhuar kafazi: të zgjerohet hapësira mes shufrave.

Kamila rrotullohet rreth vetes, me krahët hapur. Këndon.

KAMILA: Dhe gjithmonë kisha kujtuar

Se jetohej vetëm me dashuri, të papërlyer

ARGJENDARI *(sallës):* Oh! Pastaj, tekefundit, nëse asaj i pëlqen më mirë të jetojë në llum...

KAMILA: Shikoni, po t'i prekësh atje ku s'mbajnë, t'u pështysh paratë. Më ka premtuar të më bëjë pronare të një studioje buzë Senës...ose të diçkaje të këtij lloji. Një kutizë e bukur prej betoni,veshur me tapiceri kineze shantungu: merreni me mend, ai ka lidhje me tregtinë e të mëndafshave! Me pamje nga lumi, kjo përfshihet në çmim. Mua s'do më mbetet gjë tjetër veç të vështroj kalimin e maunave dhe anijeve, në pritje që, kur të mbarojë ditën e punës, zotërija të vijë të zbrazet... Molë!

ARGJENDARI: Çfarë?

KAMILA: Lloj që i përket familjes së tenjave.

ZONJA HELMIRE: Mirë, pra, mirë, mos u grindni...Pastaj përse t'ia mbyllni vetes një derë kot së koti?

KAMILA: Dua t'i jap fund kësaj meseleje, më bën të vjell ky hajvan.

ARGJENDARI: Ajo s'është në vete...

KAMILA: Vërtet... Hajde, nxirre qesen dhe jepi zonjës Helmirë gjithçka i detyrohesh!

ARGJENDARI: Sa?

KAMILA: Dhe pyet, pale!

Argjendari nxjerr portofolin dhe vendos mbi tryezë një tufë kartëmonedhash. Zonja Helmirë zhytet në punimin e trikos.

ARGJENDARI: I dhashë të gjitha

KAMILA: Molë!

ARGJENDARI: Po s' kam më asgjë moj shqerrkë, shih dhe vetë po deshe...

KAMILA: Sigurimet, patenta e makinës, karta e gjakut, e indentitetit, e kredisë, fatura e fundit e energjisë elektrike, fotografi të familjes: i duam të gjitha!

Argjendari i zgjat portofolin Kamilës.

ARGJENDARI: Mirë, pra, mbeta fare lakuriq!

KAMILA: Orën, vëre orën te pjatëza.

ARGJENDARI: *(duke u bindur)* Pa shih, qenka më vonë nga ç'kujtoja...

KAMILA: Unazën.

ARGJENDARI: *(duke kaluar dorën mbi ballë)* Ç'po më punon sonte...

KAMILA: Mos u tremb, mjafton të thuash se të ka humbur bashkë me të tjerat.

ZONJA HELMIRË: Kujdes, dikush po zbret...

Ajo vendos trikon mbi tufën e kartëmonedhave. Dëgjohen taka që përplasen nëpër shkallë. Pushim. Shfaqet Gruaja Leopard. Turfullon duke ndaluar te shkallarja e fundit.

GRUAJA LEOPARD: Ç'kohë e tmerrshme! A mund të merret në telefon provinca që këtu?

ZONJA HELMIRË: Ç'numër doni?

GRUAJA LEOPARD: 68 91 21, në Simianë-la-Rotondë.

ARGJENDARI: Është krahinë e bukur ajo.

GRUAJA LEOPARD: Keni qënë?

ARGJENDARI: Dikur kam bërë andej ekskursione në këmbë...O Zot, më duket sikur qysh nga ajo kohë kanë kaluar njëqind vjet...

ZONJA HELMIRË: Nuk ju kujtohet prefiksi?

ARGJENDARI: Ti, moj zemër, numërorin e ke, përpiqu ca...Sa më shumë i paguan këto, sa më tepër kujdesesh, aq më pak e vrasin mendjen për punën.

GRUAJA LEOPARD: Parisi, ç'qytet i mrekullueshëm! Veç të mos ishte kjo kohë e tmerrshme...Atje është verë e përjetshme...Mendoni, kur u largova nga Simiana para një jave, mbaja ende pantallona të shkurtëra! Keni të drejtë, zotëri, është një krahinë e bukur...Duhet të ktheheni përsëri atje:vjeshta është një sezon i bekuar për marshime.

ZONJA HELMIRË: (*Kamilës*) Moj zoçkë, eja shih këtu, m'i fal pak sytë për një minutë..duhet të kalojë nëpër Apt ose përmes Manoskut, shiko...

Pushim.

KAMILA: Mos lëviz, e kapa. Formo 16. Sinjal, pastaj bjeri 92. Dhe numrin.

ZONJA HELMIRË: Ç'numër doni?

GRUAJA LEOPARD: 68 91 21 në Simianë-la-Rotondë.

ZONJA HELMIRË: Kabina numër 2.Po jua nxjerr.

Gruaja Leopard futet në kabinën telefonike. Mbyll derën, pastaj e hap përgjysmë.

GRUAJA LEOPARD: Nëse nuk përgjigjet menjëherë, ju lutem këmbëngulni: ai është artist,mund të ndodhet jashtë duke mbledhur materiale. Hëna, e kuptoni, hëna e frymëzon...

ZONJA HELMIRË: Alo, Manosku...Doja numrin...

KAMILA: 68 91 21

ZONJA HELMIRË: ...68 91 21. Po. Në Simianë-la-Rotondë...Manosk, nëse nuk del, vazhdo t'i biesh, është një shtëpi e madhe.

ARGJENDARI: Ç'nevojë ke të gënjesh, Helmirë? E ç'del nga shtrembërimi i së vërtetës? Apo kujton se do ta bësh xheloze kolegen tënde të Manoskut duke i njoftuar se pranë teje ke dikë që banon në një shtëpi të madhe... Kjo është si

puna e krimbit të tokës që verbohët nga ylli, apo jo! Krimbit i duket se edhe ai shkëlqen. Pastaj, ku e di ti se ajo banon në një shtëpi të madhe? Kush e zuri në gojë shtëpinë e madhe?

ZONJA HELMIRË: Epo ku tjetër doni ju që të banojë ajo? A nuk e patë si ishte veshur?

ARGJENDARI: Kjo trashitinë është gdhë fare, shkëmb. Dhe jo çdo lloj shkëmbi!

Zonja Helmirë merr prapë trikon dhe i fsheh kartëmonedhat në sirtar.

ZONJA HELMIRË: Mund të mendoni ç'të doni, por kur njeriu vishtet si ajo, s'ka se si të banojë në një papafingo!

Argjendari tund supet. Pas shpinës së tij Kamila bën gjeste të ndyra.

ARGJENDARI: (*Kamilës*) Nuk të kam menduar kaq mizore.

KAMILA: (*këndon*)

E ardhmja hapej para meje
Si një kopsht me trëndafila
Më e qeshur se për një mbret
E ardhmja hapej para meje...

ARGJENDARI: Vërtet, çfarë do ti?

KAMILA: Gjithçka!

ZONJA HELMIRË: Po bie telefoni...

ARGJENDARI: Do të ve Parisin në këmbët e tua...

KAMILA: (*këndon*)

Atëherë nuk kisha asgjë
Asgjë prej gjëje në kuletë,
Lirën kisha, vetëm atë;
Atëherë nuk kisha asgjë...

ZONJA HELMIRË: (*duke bërtitur*) Kabina numër 2, flisni! Jeni lidhur me Simianë-Ia-Rotondën.

KAMILA: Helmira ka të drejtë, me rrobat që ka veshur, ajo nuk duhet t'ua ketë frikën fundit të muajve... Megjithatë, siç kanë ardhur kohët, mua s'do të ma mbante të dilja rrugëve e stisur kështu.

ARGJENDARI: Provinca është e qetë.

KAMILA: Kush foli për provincë? Mos jemi gjë në provincë ketu? Pa le, kujtoja se gjendemi në Paris! Vërtet nuk ha pykë ky njeri! E thashë mirë, është tamam hajvan. Doemos, kur e kalon tërë ditën e ditës i krekosur me një bluzë të bardhë, me prapanicën ngjitur pas një kolltuku te stilit Napoleoni III... prapa një banaku të të njëjtit stil, duke u shitur stolira prej ari plakusheve pasanike të zonës gjashtëmbëdhjetë... Dale, Helmirë, tregoi pak këtij se çfarë ke parë një ditë në autobus, tregoj që të zbresë me këmbë në tokë.

ZONJA HELMIRË: Më ngjethet mishi kur e kujtoj.

Pushim. Te shkalla shfaqen një palë këmbë, me gjasë, nisur nga pantallonat dhe këpucët, këmbë burri.

ARGJENDARI: Hajt tani, leri nazet, ti më detyrohesh...

KAMILA: Tregoj, Bardhoshe, pastaj këto lloj historirash ja ngrefin.

ZONJA HELMIRË: Kështu, pra, gjendesha në autobusin me numër 291, që marr zakonisht, po vija në punë: në atë orë ai është gjithmonë i mbushur plot e përplot...

ARGJENDARI: Pra, si zakonisht, ti ishe në këmbë, nëse nuk ka patur ndonjë arab për të të lëshuar vendin.

ZONJA HELMIRË: Talluni ju, por ata njerëz ngrihen më shpesh se të tjerët...

ARGJENDARI: Duhet të biesh në sy, të tërheqësh vëmendjen.

KAMILA: Në atë rast bëhej fjalë për një "patriot" të Helmirës.

ARGJENDARI: Dhe unë vë bast se ai nuk është ngritur...Ta merr mendja! Pse duhej të ngrihej për një "patriote"!

ZONJA HELMIRË: Më lejoni t'ju them, zoti Bert, se ai ishte më i zi nga ç'janë njerëzit në anët tona dhe mbante një kapuç. Martinikanët nuk mbajnë kapuç!

ARGJENDARI: (*sallës*) Për mua kjo s'ka pikë rëndësie, unë nuk i dalloj dot.

KAMILA: Mos e çaj kokën, Bardhoshe, të gjithë do të shkojmë në parajsë: Zoti i madh është dantonian, nuk i dallon ngjyrat.

ZONJA HELMIRË: Atëherë,ta tregoj apo jo? (*pushim*) Isha në këmbë dhe e mbështetur pas hekurit, me këtë! Pranë ishin ulur dy tipa: një zezak dhe një i bardhë. Shpresoja te zezaku, por u ngrit i bardhi...ama pa më ftuar të zija vend...

ARGJENDARI: Jo, po, mos doje të të dhuronte dhe orën!

Kamila merr orën te pjatëza dhe e kalon te kyçi i dorës.

KAMILA: Sidoqë të jetë, orën tënde quaje të humbur! Do të marrësh një tjetër te vitrina e dyqanit.

ARGJENDARI: *(duke psherëtirë)* S'kam ç'bëj...të gjithë duhet te kenë orë tani, andej nga ju?

ZONJA HELMIRË: Epo mirë, meqë juve nuk ju intereson të dini gjë tjetër, nuk po tregoj më!

ARGJENDARI DHE KAMILA: *(duke u përkulur së bashku mbi tryezë)* Trego...

Pushim.

ZONJA HELMIRË: Kisha veshur fustanin tim të shkurtër prej najloni ngjyrë blu të çelët, e dini, atë me lule, atë për të cilin ju thoni se është i tejdukshëm, zoti Bert.

ARGJENDARI: E kuptoj shumë mirë cilin, vazhdo!

ZONJA HELMIRË: Si çdo herë që më ndodh diçka e tillë, nuk guxoja të lëvizja...Megjithëse po më ndodh gjithnjë e më rallë: sepse kur isha e re, i tërhiqja këta masturbues siç tërheq mjalti mizat!

ARGJENDARI: Ai e kishte nxjerrë poshtë gazetës, kështu?

KAMILA: Shiko, po atje i vete mendja këtij!

Pushim. Zonja Helmirë shkërben pozicionin e saj në autobus.

ZONJA HELMIRË: E ngrirë, me çantën e dorës të rrasur pas barkut, unë vështroja drejt, përpara meje: po vetëm drejt. Dhe kështu vura re se tipi që më kishte lëshuar vendin...

KAMILA: Posi, posi! Të kishte lëshuar vendin...

ARGJENDARI: Po lëre ta çojë deri në fund! A nuk e di se është e pahijshme t'i ndërpresësh të tjerët?

KAMILA: *(sallës)* Ja dhe ky, po vazhdoi kështu do të kthehet në shtëpi gollomesh!

ZONJA HELMIRË: Tipi im i fliste shoferit, shoferi fliste në radio...

ARGJENDARI: Pra, nuk e ndeze ti...Ha,ha! Ishte pederast!

KAMILA: Thuaj që nuk është i qelbur deri në rrënjë ky njeri!

ZONJA HELMIRË: *(duke u ngritur)* Mbërritëm te porta Vanves, në mes të një zallamahie makinash, kur pam-parapam! Dhe më besoni, gjithçka ndodhi sa të

hapësh e të mbyllësh sytë: furgoni i policisë iu ngjit autobusit. Dhe, o nëne, policët që ishin atje mësynë vetëtimthi. Dhe ta mbërthejnë zezakun tim. E ta tundin, e s'i lenë xhep pa kontrolluar (*pushim*). Dhe i gjejnë një dorë mbushur me unaza: një dorë të freskët...Unë e hodha fustanin...

Duket një djalosh. Ai qëndron te shkallarja e fundit dhe kullon ujë.

DJALOSHI: Ky është një provokacion racist: ajo gënjen.

ARGJENDARI: Natyrisht! Duhet t'i ketë parë këto në një film me tmerre...Po ju, kush jeni? Sigurisht, s'jeni nga të zakonshmit. Nuk ju kam parë asnjëherë këtu...

DJALOSHI: Në të vërtetë ndodhem kalimthi.

ZONJA HELMIRË: Nuk po tregoj më!

KAMILA: (*Argjendarit*) Një dorë që do ta kishte kryer fare mirë punën tënde...

ARGJENDARI: Të lutem, t'i lëmë banalitetet faqe një të huaji...Perpiku të paktën të ruash dukjen.

KAMILA: Të dukesh, kjo është çështja! Unë dukem. Ti dukesh. Ai duket... Në djall, më mirë të këndo.

Më dashuronin...Isha e adhuruar

Sepse kisha gjithçka duhet për t'u pëlqyer:

Vështrimin shpuzë dhe provokues

Më dashuronin...Isha e adhuruar.

DJALOSHI: Dua të flas në telefon me provincën.

KAMILA: Mos ka ndonjë panair andej, tani? Nuk e dija!

ARGJENDARI: Ç'hyn kjo pyetje këtu?

KAMILA: Nuk e merr dot me mend?

ZONJA HELMIRË: Është e vërtetë, dy thirrje për provincën brenda një çerek oreje, nuk është e zakonshme: me siguri duhet të jetë hapur ndonjë panair.

Djaloshi i afrohet tryezës.

DJALOSHI: Hë,a mund të flas?

ZONJA HELMIRË: Sapo ju thashë se kabina është e zënë.

DJALOSHI: Mua? Si kështu! Më falni, por ju ishit këtu, si në familje do të thuhej... duke folur për atë që ju shqetëson, domethënë jo ndonjë gjë e madhe, mesa kuptoj nga çfarë dëgjova, dhe...

ARGJENDARI: Në familje ndoshta është ca si tepër të thuhet, por që jemi midis nesh, kjo është e vërtetë; dhe meqë më jepet rasti, me lejoni t'ju paraqis: zonjusha Kamilë dhe mikësja e saj e mirë, zonja Helmirë.

Djaloshi përkulet me radhë para dy grave.

DJALOSHI: Pa dashur të fyej askënd, dhe meqë kabina është e zënë, a ka ndonjë kafene tjetër të hapur këtu rrotull?

ZONJA HELMIRË: *(me pamje të përmalluar):* Dikur lagjja ishte tërë gjallëri...

ARGJENDARI: Me këtë ajo kërkon të thotë se nuk kishin filluar shkatërrimet... Por, sa i përket jetës, asaj tashmë i kishte dalë tabani... Në të vërtetë, unë jam nga të fundit që pres një shpronësim sipas të gjitha rregullave... Mund të kisha lëshuar, e pranoj. Jo për interes, kam para sa të duash, por sepse kjo është lagjja e adoleshencës sime. E kam të vështirë ta braktis këtë vend.

KAMILA: *(Djaloshit)* Me gjithë atë shi që bie, ju s' do të dilni prapë... Pastaj, këndej rrotull nuk ka ndonjë kafene tjetër... Meqë ra fjala, po ajo zonja si përfundoi këtu?

ZONJA HELMIRË: Duhet të ketë qenë për të ngrënë te Abdeladifi. Ja një njeri që ka përfituar nga shkatërrimi i lagjes, ai thotë se qyshse ndodhemi mes gërmadhash, ka patur punë më shumë se kurrë.

KAMILA: Është gjithë kjo ngjitje e aristokracisë që i tërheq minjtë e gjirizeve... Duke ardhur për këtu më kaloi nëpër këmbë një mi më i gjatë se krahu.

ARGJENDARI: A nuk e zmadhon njëçikë?

KAMILA: Po, të them, bashkë me bishtin ishte më i gjatë se krahu im! Unë shoh mirë, apo jo?

ZONJA HELMIRË: Duhet të na e ketë përcjellë Abdeladifi. Ai na çon myshterinj: në disa mbrëmje edhe ne kemi të drejtë të presim sëra parellinjsh.

DJALOSHI: Po ngjitem të pij një kafe...

ARGJENDARI: Kursejini hapat, or mik, makina e kafes është një nga sendet e para që i dhamë duart. Kam mbajtur xhuboksin për këto zonjat por duhet thënë

edhe për vete: ndonjëherë vallzojmë këtu. Dhe, për të tjerat, po shesim ç 'na mbetet...Jemi në pritje: mbase na vjen radha ta thyejmë qafën nesër.

ZONJA HELMIRË: Edhe vajza ime kështu thotë, por në rastin e saj është çështje jete...

ARGJENDARI: Të mos flasim për gjëra të zymta këtu, të premtën në mbrëmje, është e ndaluar!

Djaloshi ecën nëpër dhomë duke tundur flokët e lagur.

DJALOSHI: S'do të doja ta thosha, po sa llafazane mund të jenë gratë!

Hapet dera e kabinës telefonike dhe shfaqet Gruaja Leopard me fytyrë të prishur. Në dorë mban kapelen.

GRUAJA LEOPARD: Mbaroi!

ZONJA HELMIRË: Do t'jua bëj llogarinë menjëherë.

DJALOSHI: Pa dashur t'ju detyroj, a nuk mund të kërkonim më parë numrin tim?
Është urgjente!

GRUAJA LEOPARD: Gjithmonë kështu kujtojmë dhe pastaj...

ARGJENDARI: Zonjë, nuk ndiheni mirë?

DJALOSHI: Shënoni:16 31 37 06 21

ZONJA HELMIRË: Departamenti?

Kamila pi cigare në fund të shkallës. Argjendari i afrohet tryezës duke mbajtur Gruan Leopard.

ARGJENDARI: Tunde bythën Helmirë, nuk e sheh se kësaj po i del e bardha e syeve?

DJALOSHI: S' keni nevojë për departamentin meqë jua dhashë prefiksin.

ZONJA HELMIRË: Në sirtar kam alkool mendre dhe sheqer.

Argjendari e vendos gruan Leopard në karrige, prapa tryezës. I hap mantonë. Skena befas zhytet në errësi.

DJALOSHI: Defekt, edhe kjo na duhej.

Kamila zhduket. Dëgjohen takat e saj që kërcasin te shkallët.

ARGJENDARI: Po ti, ku shkon ti?

KAMILA: Të shoh mos janë hidraulikët...

ARGJENDARI: Gënjeshtare! Ti po shkon të pish atje lart...Më mirë thuaji Luisit të na zbresë shampanjë. Po, shampanjë, shampanjë!

ZONJA HELMIRË: Fatmirësisht në sirtar kam qirinj, herën e fundit ndërprerja zgjati dy orë e gjysmë.

Zonja Helmirë hap sirtarin. Gruaja Leopard gjendet e zënë midis sirtarit dhe murit.

GRUAJA LEOPARD: *(duke iu marrë fryma)* Telefoni është një shpikje e kobshme... *(qan)* ...dhe e kam ditur gjithmonë se ai do ta përdorte për të më braktisur... Është shumë e lehtë ta ndërpresësh një zë. Ai ma mbylli telefonin para hundës *(tërheq hundët)*, pasi më tha se midis nesh kishte marrë fund... Mbaroi!

Argjendari ndez një shkrepëse.

ARGJENDARI: *(sallës)* Dikur kisha një çakmak, e mbaja veten për një qenie njerëzore, kur në të vërtetë isha vetëm një kafshë spitullaqe!

DJALOSHI: Më kishin thënë vërtet se në Paris çfarë nuk të shohin sytë...

Zonja Helmirë rrëmon në sirtar.

ZONJA HELMIRË: Alkooli i mendrës ka avulluar, sheqeri është zhdukur, pakoja me qirinj ka fluturuar. Më në fund, paskan patur mirësjelljen të më lënë një qiri.

ARGJENDARI: Shpejt zemra, shpejt, se po digjem, ma zgjat bythën e qiririt që ta nxeh.

Zonja Helmirë i zgjat qiririn Argjendarit, i cili e nxeh, pastaj e vendos mbi monedhën e ngjitur në qendër të pjatëzës. Disa kartëmonedha gjenden të shpërndara përtokë. Zonja Helmirë përkulet për t'i mbledhur por Argjendari ia bën me shenjë të mos lëvizë.

DJALOSHI: Tani që ju mund të shihni...

ZONJA HELMIRË: Sigurisht, ma kujtoni pak numrin?

DJALOSHI: Po ju e kishit të shënuar mbi një copë letër...

Zonja Helmirë kërkon në xhepat e bluzës.

DJALOSHI: Gjithsesi, është 16 31 37 06 21

ARGJENDARI: Prisni, dhe më falni për kureshtjen: a jeni i fejuar? Ose, të paktën, mos doni t'i telefononi vajzës që ka pushtuar mendimet tuaja?

DJALOSHI: *(duke përplasur këmbën përtokë)* Jo!

ARGJENDARI: Jo çfarë?

DJALOSHI: Jo, unë nuk jam i fejuar, dhe nuk dua...Oh! Dhe pastaj, ky është kulmi!

Përveçse si një kafshë spitullaqe, mos e mbani veten edhe për detektiv privat?

ZONJA HELMIRË: *(Gruas Leopard)* E ka nga xhelozia, ai e vuri re se vogëlushja

tregoi vëmendje për djaloshin: nuk ia ka besën njeriu...Ju hëngrët te

Abdeladifi? Duket është mirë atje, apo jo? Por edhe çmimet...

ARGJENDARI: Më pëlqen arroganca juaj. Në moshë më të re edhe unë, po të më

shtrydhje, kulloja arrogancë. Dhe e di se të tjerët thonin për mua tërë qejf: ky

është një karabush... Sot më pëlqen të sillem kokë ulur. Njeriu ndryshon. *(me*

zë të ulët) Do të ndryshoni...

DJALOSHI: *(duke i kthyer shpinën Argjendarit)* Do të ishte më e goditur fjala

degradim.

ARGJENDARI: Pa dyshim, ai më pëlqen!

DJALOSHI: *(sallës)* A ka ndonjë nga publiku që mund të më huazojë 148 franga e

50 qindarka? Është çmimi i biletës së trenit Paris -Kanë, në klasin e

dytë...Kam dy ditë që provoj autostopin: pa sukses. Dhe, për t'u zbrazur deri

në fund, më duhet të them se po filloj të kem uri! Të shoh minj gjirizesh, të

gjatë sa krahu i zonjushës, që ishte pak më parë këtu.

GRUAJA LEOPARD: *(përmes lotëve).* Duhet të më thirrni një taksì.

ZONJA HELMIRË: Unë vërtet do të doja, por ata nuk vijnë deri këtu...

DJALOSHI: Nëse nuk keni frikë se mos ju ndrag, futmëni krahun, zonjë, dhe do t'ju

çoj deri te bulevardi, ku do ta kapim një taksì në vend.

ARGJENDARI: Para se të largoheni...një gjë të fundit, fare të vogël, pa pikë

rëndësie! Kur njeriu, ashtu si ju, ka mençurinë që të mos e marrë një fjalë për

një tjetër - po shpjegohem: të mos e lërë veten të mashtrohet nga

bashkëbiseduesi i tij - a nuk provon ky njeri kureshtjen për të mësuar përse

degradon? Do të ishte një pakujdesi për një mendje si juaja, që hamendësojmë

se është e shkëlqyer!

DJALOSHI: Hamendësoni?

ARGJENDARI: Shihni si gërmushet... Lafsha i ngrihet përpjetë dhe shytat i

fryhen...puplat e gjoksit i kreshpërohen... a do të na e lëshojë kikirikinë e tij

shpërthyesë? Ai kujton se është njeriu më i mësuar midis nesh;sa dritëshkurtër

është! Mirë, pra, qesh Helmirë! Së paku zbavitu ti zemra, ti që ai me siguri të mban këtu për më budallaqen!

ZONJA HELMIRË: (*Gruas Leopard, së cilës i përkëdhel supin mekanikisht*) Mos e çaj kokën, këto prej kohësh mua nga një vesh më hyjnë, nga tjetri më dalin.

DJALOSHI: Po ju pres, zonjë.

GRUAJA LEOPARD: S'më bëjnë më këmbët, pastaj gjithë kjo errësirë... Ky qytet ku jemi takuar dymbëdhjetë vjet të shkuara... Ishulli i Mjellmave... Sheshi Gijom-Apoliner... Shtëpia te liqeni. Lokali i rumit në bulevardin Sen-Zhermen... Kafe Flora. Ura Aleksandri III... Urat! Kopshti i Poetëve, Luksemburgu... Birraritë e vogla që zbulonim... Për ne: vetëm për ne! Parisi, sinonim i lumturisë, dhe kaq armiqësor këtë natë: oh, kaq armiqësor!

Ajo shpërthen në lotë. Zonja Helmirë mbron me duar flakën e qiririt që lëkundet. Argjendari ecën nëpër dhomë, me duar të lidhura pas shpine.

ARGJENDARI: Shtëpia e prindërve të mi gjendej përballë një punishteje për prodhimin e lëngut të mollëve. Dimër-verë te ne vinin duhmat e mollëve të kalbura, muret ishin të ngopur me atë erë frutash të prishura dhe çdo gjë që fusja në gojë më dukej sikur kishte shijen majhoshe të tullit të prishur. Re mushkonjash fluturonin mbi koshat e braktisur në oborrin e madh, duke krijuar një vijë të amullt pingule ndaj hekurit mbështetës të dritares së dhomës sime: pikërisht në lartësinë e syve të mi. Gjatë disa netëve me hënë të plotë unë kam parë në ato kosha të gëlojë jeta...dhe pa dashur të rrëmoj fort në të thella, do të thosha se në atë periudhë duhet të jetë zhvilluar tek unë shija për kalbësirën: shija e degradimit, nëse pëlqehet më shumë kështu!

DJALOSHI: (*Gruas Leopard*) Pra, të iki pa ju?

ZONJA HELMIRË: Si t'ia themi atij?

ARGJENDARI: E çuditshme, më lëngëzon goja vetëm duke e sjellë ndërmend.

GRUAJA LEOPARD: Herën e fundit që kemi ardhur këtu së bashku, ka qenë muaji maj i vitit të kaluar...Ai çeli një ekspozitë në galerinë e ishullit Sen-Luis: një dështim. Erdhën vetëm pesë vetë: katër miq dhe një zonjë, që kalonte andej me qenin e saj. Ajo piu shampanjë me ne, hëngri dhe nga gatesat e vogla të rastit, madje dëndi me to edhe kafshën e saj, por pikturat nuk mori as mundimin t'i shihte...

ARGJENDARI: Ajo duhet ta ketë marrë galerinë në fjalë për një sallon çaji. Megjithëse ç'është e vërteta në sallonet e çajit nuk shërbehet shampanjë...Zonjë, po ju ofrohet një krah, i ri dhe i fuqishëm: kapeni!

ZONJA LEOPARD: Për të vajtur ku, zotëri?

Argjendari ngre krahët drejt qiellit. Zonja Leopard shembet në shpinoren e karriges, zonja Helmirë i bën fresk me kapelen. Qiriri fiket nga era. Duke përfutuar nga errësira, Djaloshi zhduket.

ARGJENDARI: Po fillon bukur kjo mbrëmje!

AKTI II

Qiriri është ndezur. Gruaja Leopard, e ulur në karrige, dënes me bërrylat të mbështetur mbi tryezë dhe fytyrën midis duarve. Prapa saj, në këmbë, zonja Helmirë përpiqet të shtyjë me këmbë disa kartëmonedha drejt qoshes së murit. Argjendari ecën nëpër dhomë me duar të rrasura në xhepat e xhaketës. Dëgjohet një tringëllimë gotash, pastaj zëri i Kamerierit, të cilit i shihen fillimisht pantallonat e zeza dhe fundi i përparësës së bardhë. Një elektrik dore varet i kapur te kordoni i përparësës së tij.

KAMERIERI: (zë) Disa thonë se ndodhi në Blanshë, në fund të udhës pa krye, të tjerë në rrugën Rider. (ai shfaqet i trazuar, ngarkuar me një tabaka të rëndë) Megjithatë një veturë-bombë sapo shpërtheu dy hapa prej këndeje! Për besë, çfarë buçime! Dëgjuat gjë ju?

ZONJA HELMIRË: (Argjendarit) Dëgjuat gjë ju, zoti Bert?

Kamerieri vendos tabakanë mbi tryezë. Pastaj e shkarkon nga katër gota shampanje dhe dy kova mbajtëse të shampanjës, secila me nga një shishe.

ARGJENDARI: (Zonjës Helmirë) Ç'u bë copa e letrës ku shënove numrin e atij tipit, që ishte këtu pak më parë?

ZONJA HELMIRE: Edhe juve ju duk je fort në rregull ai?

Ajo kërkon nëpër xhepa, sheh përtokë rreth saj .

KAMERIERI: Zoti Bert, të shërbej unë apo ju pëlqen më mirë ta bëni vetë?

ARGJENDARI: Shko Luis, thuaji zonjës Lekyje se edhe ajo mund të largohet. Helmira do të ngjitet lart t'i mbyllë dyert pas jush.

Kamerieri tërhiqet. Ai ndalon te shkallarja e katërt dhe kthehet.

KAMERIERI: Për pak harrova, zonjusha Kamilë më porositi t'ju vija në dijeni se ajo nuk do të kthehet më...Megjithatë, siç më kërkoi ajo, unë zbrita katër gota...Portofolin tuaj ajo ia la zonjës Lekyje, e cila e futi në arkë.

ARGJENDARI: S'tha gjë tjetër?

KAMERIERI: Asgjë më shumë...Por, nëse kjo mund t'ju qetësojë, zoti Bert, mushamaja e saj gjendet te varësja e rrobave dhe, e veshur hollë, me kohën që po bën, ajo s'do të shkojë shumë larg për të shëtitur!

ZONJA HELMIRË: E çmendura!

ARGJENDARI: Faleminderit, Luis, mirë u pafshim të hënën... Atëherë, do të ma gjesh atë copë letre, apo ç'mutin do bësh!

GRUAJA LEOPARD: Kam dëshirë të bëhem tapë!

ARGJENDARI: Epo mirë, ç'prisni, mbushni një gotë!

Gruaja Leopard mbush një gotë me shampanjë dhe e kthen me një frymë. Argjendari mbush tri të tjerat dhe i shërben Gruas Leopard, që e zbraz gotën menjëherë. Zonja Helmirë hap musandrën, prej nga nxjerr një gotë të zakonshme, që ia tregon Argjendarit.

ZONJA HELMIRË: Jo se dua të dallohem, por unë kam zakonet e mija.

ARGJENDARI: Bën mirë sepse ata do të kthehen...

ZONJA HELMIRË: As mos e çoni nëpërmend...Ia di unë kokën asaj.

ARGJENDARI: Ti nuk di asgjë. Edhe unë bashkë me ty: është një lëmsh i ngatërruar ajo vajzë! Dhe mendoj se prej saj mund të presësh gjithçka, është e zhgënjyer nga jeta para kohe...Ngrije këmbën Helmirë, shiko, ajo që ke të ngjitur pas gjurmashkës, mos është copa e letrës që kërkojmë?

ZONJA HELMIRË: Të ishte për mua, do të vazhdoja të kërkoja!

ARGJENDARI: Ma jep ketu...(ai zbraz gotën e tij dhe vështron vëmendshëm copën e letrës). Përfytyro, Helmirë, moj shpirte,sikur ai karafili të ketë ndonjë lidhje me shpërthimin e veturës-bombë këtë mbrëmje...Nesër fotografite tona... (ai e merr zonjën Helmirë midis krahëve)... në faqet e para të gazetave, në të gjithë vendin...Dhe çfarë titujsh, dëgjomë: "Një argjendar i ndershëm dhe një zonjë jo më pak e ndershme, zonja çiči, sepse nuk duhet të kemi frikë nga fjalët, hedhin në erë një nga rrjetet më të rrezikshme të terrorizmit ndërkombëtar" (ai e lëshon zonjën Helmirë dhe bërtet) Luis... (pushim). Mos u shtir sikur ke ikur. Të tradhëton era

KAMERIERI: (zë) Nuk kam ikur, zoti Bert, dhe sa për erën, dita e punës ka mbaruar.

ARGJENDARI: Nuk ka mbaruar dita e punës, or mik, kanë mbaruar këmbët e tua.

Hajt, lëviz, gotat kanë nevojë të mbushen.

Argjendari ecën nëpër dhomë me hapa të mëdhenj, duke vajtur e ardhur tri herë përgjatë saj. Nëpër shkallë dëgjoheh hapat zvarrë të Kamerierit. Ai shfaqet me kostum, me një berretë baske në kokë. Argjendari ia ngul sytë.

ARGJENDARI: Mos ke harruar gjë, Luis?

KAMARIERI: Jo, zoti Bert, atje lart gjithçka është në rregull dhe i thashë zonjës Lekyje të largohet.

Pas shpinës së Argjendarit, zonja Helmirë ia bën me shenjë Kamerierit për t'i treguar se ka harruar të vërë përparësen.

GRUAJA LEOPARD: *(duke treguar me gisht Kamerierin)* Përparësen.

KAMARIERI: Zonjë, me gjithë respektin që kam ndaj jush, nuk do ta vë. Orari është orar dhe mua po më pret gruaja.

ARGJENDARI: Pa shih, dhe cila grua?

Kamerieri heq berretën dhe zhduket.

ARGJENDARI: Sa shpejt preken dhe këta spanjollët!

ZONJA LEOPARD: Vërtet. Dhe çfarë të ikure!

Argjendari tund supet, pastaj mbush gotat. Gruaja Leopard e kthen të vetën me fund dhe e rimbush aty për aty. Zonja Helmirë e pi të vetën në dy kohë. Kur zbrazet gota e saj, Argjendari ia mbush.

ZONJA HELMIRË: Ngavash, i kam premtuar vajzës sime të shkoj ta shoh nesër në vizitat e mesditës...

GRUAJA LEOPARD: *(ankueshëm)* Ah! Do të doja të vdisja!

ZONJA HELMIRË: Diku, dikush *(kthen një gllënjë të madhe shampanjë)*...diku, dikush *(e zë lemza)*... rrotullon majën e gjuhës për të parë vrazjen e një plage të freskët...Diku, dikush, me kokën midis duarve, nuk dëshiron të vdesë *(e zbraz gotën)*. Televizioni punon...gjithçka vazhdon të punojë! Mos thoni se doni të vdisni kur i keni të gjitha...

GRUAJA LEOPARD: Po unë s'kam më asgjë, pa atë unë... Unë vuaj nga e njëjta dhimbje si vajza juaj: nga një dhimbje që vret!

Ajo zhyt fytyrën te kapelja. Kamerieri shfaqet përsëri, me përparëse të vënë. Ai i shërben zonjës Helmirë dhe Gruas Leopard.

KAMERIERI: Policia është e pafuqishme ndaj këtyre atentateve e megjithatë, sapo del nga shtëpia, është e pamundur të mos përplasesh me ndonjë uniformë blu!

ARGJENDARI: Nga vjen ai? Kush është? Nuk e kemi parë kurrë këtu... Tha se ndodhej kalimthi. Po kush kalon sot këndeje? Kjo rrugë nuk ka më as pllakë! Një rrugë pa emër. Kush kalon në një rrugë pa emër?

GRUAJA LEOPARD: Unë! Mund të kisha qëndruar te... si e quani ju?

KAMERIERI: *(në mes të dhomës, me shishen në dorë)* Abdeladif.

GRUAJA LEOPARD: Po dëfreheshim atje, kur befas mbulesa prej letre e tryezës m'u duk e lerosur, edhe ushqimi, edhe fytyrat e njerëzve, gjithçka! Dhe pata dëshirë të dëgjoja zërin e tij. Por tek ai, të cilit ju se si ia thoni emrin, nuk mund të flasësh në telefon me provincën. Një nga kamerierët e tij më përcolli deri në mes të rrugës...Dhe humba dhjetë herë. Asnjë emër rruge, asnjë shenjë...Por në fund fare, zëri i tij...

ARGJENDARI: Sa për t'ju thënë atë që ju tha zëri...Do të kishit kursyer disa monedha po të vazhdonit të defreheshit.

GRUAJA LEOPARD: Zotëri, a nuk mund të silleni pak më me dhembshuri?

ARGJENDARI: Pse, çfarë tjetër po bëj unë? Përderisa ndodhem këtu duke ju dhënë të pini qyl...Zonjë... Tek e fundit, zonjë, ne nuk njihemi! Më lejoni *(ai përkulet para Gruas Leopard)* Norbert, Norbert Kombrëshu, argjendar.

Ai sajon një puthje dore.

GRUAJA LEOPARD: Salomé: Salomé dë la Grandierë. Në një kuptim, jam e gëzuar që ai e shihte gjithmonë martesën si një kafaz: sepse, veç të tjerash, do të më kishte zhveshur edhe nga mbiemri im! Si çdo vajzë edhe unë kam ëndërruar të mbaj mbiemrin e një burri. Të mbaja mbiemrin e një burri do të thoshte të futesha brenda tij përgjithmonë... të braktisja mbiemrin e babait. Unë do te quhesha Salomé Dyfur: mospërputhja duket që larg! Por vetëm Salomé, Salomé pa asgjë, a nuk është më keq se Salomé Dyfyr?

ARGJENDARI: Sidoqë të vijë puna, shpirtja ime Helmirë, nëse ai kthehet, mos ia lidh atë numrin që kërkon pa ta hapur unë dritën jeshile. Sajo ç'të të vijë në mendje, futja, linja e zënë, një ndërhyrje... Ty nuk ta ha qeni shkopin për këto! Unë, nga ana ime, do ta zhbiroj. S'duhet humbur rasti për të zënë në kurth

ndonjë nga këto plehëra! Ndërsa ti, Luis, ti do të rrish atje lart deri në një urdhër të ri. Gratë e tua presin.

KAMERIERI: Zoti Bert...

ARGJENDARI: Pa tjetër, or mik, do t'i marrësh orët shtesë.

KAMERIERI: Nuk e kisha fjalën aty, zoti Bert...Edhe mua pamja e tij m'u duk disi e çuditshme.

ARGJENDARI: Një arsye më shumë për të qëndruar atje lart. Në çastin e duhur, vetë i dytë nuk do të jemi tepër.

Argjendari e godet në sup Kamerierin, i cili zhduket.

KAMERIERI: (zë) Kemi vizitorë.

Djaloshi shfaqet te shkalla, me një shkrepëse të ndezur në dorë.

DJALOSHI: Zonjë, ju gjeta një taksi, po ju pret përpara derës, nuk do t'ju duhet të ecni.

GRUAJA LEOPARD: Të shkojë në djall! Mos kujtoni ju se një natë si kjo kam dëshirë ta kaloj krejt e vetme në ndonjë dhomë hoteli? Unë, që zakonisht e urrej vetminë?

DJALOSHI: Në këtë rast po shkoj të njoftoj shoferin. S'duhet t'ua humbasësh kohën njerëzve që punojnë.

GRUAJA LEOPARD: Ndjenjat e mira, aq të dashura për rininë, që është e dhënë pas drejtësisë dhe lirisë, i kultivonte dhe ai, megjithëse është dyzet vjeç dhe jeton mbi kurrizin tim si rriqna në lëkurën e qenit! E dini pse u ngjita në Paris pa të?

ARGJENDARI: Merrni një gotë, Djalosh, keni ngrirë së ftohti.

DJALOSHI: Kështu ju duket, nuk e kam zakon të pij...

ARGJENDARI: Merreni, pra, hajt! Ka edhe më zi se kaq...

Djaloshi merr gotën që i ofrohet dhe e çon te buzët. Argjendari heq tapën e shishes së dytë, që kërcen përtpjetë...Në këtë çast tringëllin zilja e telefonit. Zonja Helmirë ngre receptorin.

ZONJA HELMIRË: Kafja e... Ah, je ti... (Ia zgjat receptorin Argjendarit). Është për ju, zoti Bert.

ARGJENDARI: Ajo?

Zonja Helmirë bën po me shenjë.

ARGJENDARI: Shqerrka ime, ti je?...Dakord, si të duash...Ku ndodhesh? Më thanë se ke dalë pa e veshur mushamanë, dhe me këtë kohë!

DJALOSHI: (*Zonjës Helmirë*) Numrin tim duhet ta kërkonit me PVC, paguan ai me të cilin do të flas, unë kam mbetur pa asnjë grosh; e kuptoni sa e ngutshme është puna...

ZONJA HELMIRE: Do ta kërkoj sapo të mbarojë ai.

ARGJENDARI: U kuptuam, ngjite veshin tënd të vockël pas telefonit. (*ai heq unazën, të cilën e hedh mbi pjatëz*) E dëgjove? Unë nuk kam më adresë, s' kam kujtime...Në gjunjë... (*ai bie në gjunjë*)...po natyrisht në gjunjë. ...Prano: thuaj po dhe do të jesh e mbrojtur për gjithë jetën. Do të të ndihmoj ta harrosh kush ka genë Kamila.

GRUAJA LEOPARD: Sidoqoftë, unë nuk e kam ulur veten kurrë deri në këtë pikë.

ZONJA HELMIRË: Po kjo i pëlqen atij. Siç thotë vogëlushja, kështu i ngrihet...Ata nuk flenë bashkë, mos e diskuto... Kur i japin fund takimit, ajo e prek pak me dorë në nevojtoje, asgjë më shumë.

DJALOSHI: Kjo...kjo është e neveritshme!

ARGJENDARI: (*me gjysmë zëri*) E respektoj heshtjen tënde...Një vendim i tillë nuk merret pa u menduar. Unë do të pres këtu, i varur në fund të fillit, po, fjala i varur është pikërisht fjala e përshtatshme moj, shqerrkë... Po pres, mendohu sa të duash...Por të paktën merr frymë: një herë të vetme që të ndiej praninë tënde...

DJALOSHI: Kjo mund të vazhdojë gjatë.

ZOBJA HELMIRË: Varet, meqë ajo i telefonon nga kabina te qoshja e rrugës, ka raste kur ai më dërgon ta kërkoj, në raste të tjera dikush e përzen vajzën prej andej dhe na qëllon ta kalojmë tërë natën të dy, duke folur për të.

ARGJENDARI: Një frymë ...

DJALOSHI: Harrova dhe taksinë!

ZONJA HELMIRË: Lëre, duhet të jetë larguar, këtu ata nuk presin kurrë ...Dhe ma zgjatni gotën, tani jeni më pak i zbehtë se ca më parë.

DJALOSHI: Kjo të bie shpejt në kokë.

ZONJA HELMIRË: Sidomos kur e ke barkun bosh.

DJALOSHI: Kush e tha këtë?

ZONJA HELMIRË: Dallohet, si hunda në mes të fytyrës!

GRUAJA LEOPARD: Kur e njoha atë, nuk ishte aspak më i bëshëm se ju, fytyrë tërhequr, e njëjta çehre e hirtë dhe sytë e tij të zinj të mëdhenj, të rrethuar me rrathë që i përpinin gjysmën e fytyrës: me pamjen e tij prej zorrërrari... Ju më kujtoni atë.

Djaloshi ul kokën...Pushim.

DJALOSHI: Dikujt duhet t'i kenë humbur para, nën tryezë ka disa kartëmonedha.

Zonja Helmirë vendos njërin gisht te buza.

ZONJA HELMIRË: Hesht! Kjo është pjesë e lojës.

DJALOSHI: Çfarë loje? Para të hedhura përtokë? Nuk e kuptoj!

Zonja Leopard kthen një gllënjë të madhe, ia merr një kënge dhe kthen përsëri një gllënjë të madhe.

ZONJA HELMIRË: Në orët e vogla, kur vogëlushja të jetë bërë tapë, nëse ajo kthehet këtu, ai do t'i kërkojë asaj t'i mbledhë...Ajo do të rrëzohet përtokë, në atë çast ajo rrëzohet gjithmonë dhe unë nuk e di se si ia del kësaj pune, por gjithmonë dërrmon fytyrën...Duhet thënë se pllakat e dyshemesë, sidoqoftë, nuk janë dhe aq të buta!

DJALOSHI: Po kush nga ata të dy e poshtëron tjetrin, kush?

ZONJA LEOPARD: Siç ndodh gjithmonë, të dy!

ARGJENDARI: Një frymëmarrje, vetëm një frymëmarrje të lehtë...

DJALOSHI: Dhe ju merrni pjesë në gjithë këtë skenë pa bërë asgjë? Kujtoja se e donit shumë atë vajzë.

ZONJA HELMIRË: Ajo më jep edhe mua nga ato para...

DJALOSHI: Gënjeni! Siç gënjyet pak më parë me atë historinë e dorës! (*ai zë kokën me duar*) Nuk besoj asgjë, asgjë nga ç'kam dëgjuar qyshse zbrita në këtë vrimë të mallkuar!

GRUAJA LEOPARD: Dhe s'keni dëgjuar më të bukurën...

DJALOSHI: As që dua ta dëgjoj!

ZONJA HELMIRË: Fjala e mallkuar është krejt me vend...

ARGJENDARI: Do ta kremtojmë ceremoninë e martesës në Sent-Ëstash, me organo, ti e veshur në të bardha...Engjëlli im, unë do të të pastroj...Mos më lër më gjatë pa atë frymëmarrje...

Djaloshi shkon e vjen nëpër dhomë, me kokën midis duarve.

DJALOSHI: Pra, nuk e takojmë kurrë miken e jetës?

GRUAJA LEOPARD: Po, ndoshta në një marrëdhënie me letërkëmbim...

DJALOSHI: Ndryshe?

GRUAJA LEOPARD: Bashkohemi me një person të seksit të kundërt, i cili me kohë na ngjit zgjeben dhe të cilit ne i ngjisim morrat: dasma shtyhet gjithmonë për më vonë...

ARGJENDARI: Një frymëmarrje...

Pushim...Nëpër shkallë dëgjoen përplasje takash. Kamila, e bërë qullë nga shiu, zbret shkallët duke ndriçuar me një llampë elektrike. Kur mbërrin te shkallarja e fundit, ndalon dhe e hedh tufën e dritës mbi secilin prej personazheve, njëri pas tjetrit: në fillim ndriçon Djaloshin, pastaj Gruan Leopard, vijon me Zonjën Helmirë dhe në fund e ndalon mbi Argjendarin.

KAMILA: Të rejat prej andej lart janë të këqija: bie shi!

ARGJENDARI: Kur ike nga telefoni, sa kohë ke që s'më dëgjon?

KAMILA: Sa të duash...Përsa i përket defektit elektrik, nuk është ndonjë sabotim, e ka fajin stuhija.

Argjendari ngrihet, merr pjatëzën dhe shkon drejt Kamilës.

ARGJENDARI: Pra, nuk ke dëgjuar gjë?Ja...Shikoje...

KAMILA: Florenca-Norbertit! Ndërsa ajo që mban në gisht gruaja e tij: Norberti-Florencës! *(ajo tërheq një gjilpërë flokësh nga topuzi, ia kalon unazës dhe e afron te flaka e qirit)* Zjarri pastron gjithçka!

Zonja Helmirë përkulet për të marrë receptorin.

DJALOSHI: Saktësoni se është nga ana e Gregut për Lysienin...Doni t'jua kujtoj numrin?

ZONJA HELMIRE: S'është nevoja, e kam në kokë

ARGJENDARI: *(Kamilës)* Shampanja jote duhet të jetë ngrohur. *(ai shkon deri në fund të shkallës)* Luis, na sill shampanjë të freskët, or mik!

GRUAJA LEOPARD: Përveç tuajës, vendosni dhe një shishe nga unë , zoti Kombrëshu.

Argjendari përkulet.

ARGJENDARI: Dy të freskëta, Luis!

Kamila merr gotën e saj plot dhe pasi kthen një gllënjë shampanjë, pështyn.

KAMILA: Vërtet është ngrohur... *(ajo ngërdheshet)*...dhe mesa duket e ngrohur të deh më shpejt.

ZONJA LEOPARD: A nuk është e rëndë jeta?

KAMILA: Mos ma zini me gojë, lëkura ime e di!

ZONJA HELMIRË: Mesa duket, s'do të përgjigjet njeri...

DJALOSHI: E pamundur, është një pension familiar, dhoma e tij ndodhet në katin e tretë, ndërsa telefoni poshtë, në korridor...

Në një qoshe Argjendari duket sikur lutet me duart të bashkuara.

GRUAJA LEOPARD: E ç'qëllim ka udhëtimi im tani? Asnjë qëllim. U ngjita deri në Paris për të shitur një stoli të families, që e mbaj unë: një gjerdan, i cili dikur i përkiste gjyshes që më ka rritur *(ajo hap çantën dhe vendos mbi tryezë një peshtaf)*. Është këtu, këtu brenda.

ZONJA HELMIRË: Mbase ka dalë jashtë...

DJALOSHI: Ju lutem këmbëngulni, jua thashë se dhoma e tij ndodhet në katin e tretë, pastaj unë ia di zakonet...

ZONJA LEOPARD: Po, po, kështu kujtojmë!

KAMILA: Mund ta shoh pak?

GRUAJA LEOPARD: Shikojeni, përfitoni nga rasti, qëllon rrallë të shohësh një mrekulli të tillë jashtë vitrinës së një argjendari.

Kamila hap peshtafin.

KAMILA: Është si një gjerdan mbretëreshe!

GRUAJA LEOPARD: Në një farë mënyre gjyshja ime ishte mbretëreshë.

ZONJA HELMIRË: Zilja bie vazhdimisht, kështu do të zgjoni tërë shtëpinë.

Djaloshi i drejtohet kabinës me numrin 2. Kamila e ndriçon.

KAMILA: Kujdes, mos pengoheni.

Djaloshi nuk përgjigjet. Ai mbyllet në kabinë. Dëgjohej një vërshëllimë dhe shfaqet Kamerieri me nga një shishe shampanje në secilën dorë.

KAMERIERI: Me siguri është një defekt në zonë, nuk ka asnjë dritë të ndezur gjëkund.

ARGJENDARI: Përreth kudo errësirë...Kafja e Madhe është e shkretë: ne jemi vetëm! Pak a shumë si ata njerëzit në një ishull të shkretë që kanë shpëtuar nga mbytyja e anijes dhe, e pranoj para jush, diçka e tillë më pëlqen...Kam një përshtypje të fortë, dhe sigurisht errësira luan rolin e saj në këtë mes, se kjo është fundjava e fundit që kalojmë këtu... E ndiej, letra do të mbërrijë të hënën (*ai kthehet, tregon Zonjën Helmirë*). Ndërsa kjo dëshironte që unë të thërrisja hidraulikët ... Bashkë me ngrehinën, shkatërruesit do të marrin me vete mutin dhe një pjesë të rinisë sime. (*ai merr dy shishet e shampanjës nga duart e kamerierit dhe i vendos në kovat mbajtëse të shampanjës*) Quesaco, po kjo nga doli?

GRUAJA LEOPARD: Nga çanta ime!

Djaloshi hap derën e kabinës dhe nxjerr kokën.

DJALOSHI: Mos i keni marrë gabim shifrat e numrit?

ARGJENDARI: (*Gruas Leopard*) Më lejoni ...(*ai i hedh Kamilës një vështrim vjedhurazi*) Siç e kuptoni, unë jam amator i gjërave të bukura...

GRUAJA LEOPARD: Shikojeni.

ZONJA HELMIRË: Gjithsesi, linja u shkëput, dhe u bë mirë për mua sepse po fillonte të më dhimbte krahu

KAMILA: (*Argjendarit*) Pra, do ta pimë shampanjën, apo jo?

ARGJENDARI: (*Zonjës Helmirë*) Na i hap këto shishe, zemra, por që të kërcasin, ama!

KAMERIERI: Atëherë unë jam kot këtu, e megjithatë e vura përparësen.

ARGJENDARI: Ti nuk e vure përparësen për të shërbyer, Luis, por që njerëzit të të dallojnë nga diçka tjetër dhe jo nga era e këmbëve të tua. Pastaj, ti ke një mision për të kryer, e harrove?

Kamerieri ngjit shkallët përsëri duke tundur supet. Zonja Helmirë ua heq tapat të dyja shisheve. Ajo mbush katër gotat si dhe gotën e saj. Kamila e fut llampën elektrike në

dekoltenë e fustanit, tufa e dritës i ndriçon një pjesë të fytit dhe fytyrën. Ajo merr dy gota dhe bashkë me to shkon drejt kabinës telefonike.

KAMILA: *(Djaloshit)* Kjo do t'ju ndihmojë te keni durim *(i zgjat gotën)* Pastaj është e cilësisë së mirë

DJALOSHI: Prandaj rrokulliseni ju përtokë në çdo fund javë?

KAMILA: Rrokullisem edhe në fillim, edhe në mes të javës... Është pjesë e lojës...

ARGJENDARI: *(Gruas Lopard)* Mos keni për qëllim t'i jepni duart kësaj?

GRUAJA LEOPARD: Këtë doja të bëja ... Por tani që gjithçka mbaroi ... Pastaj, kjo nuk është ndonjë çikërrimë, argjendari i Simianë-la-Rotondës, tek i cili kam besim te plotë, ma ka vlerësuar për tridhjetë e pesë mijë franga!

ARGJENDARI: Po pse nuk jua bleu?

GRUAJA LEOPARD: Ai merret vetëm me gjëra të zakonshme, por pati mirësinë të më lidhte me të vëllanë, që ka një dyqan në rrugën Fobur-Sent-Honore.. Fjala ishte të takoheshim nesër, në vaktin e drekës. *(ajo zbraz gotën e shampanjës)*. Po pse të shkoj, ç'më duhen ato para tani...

KAMILA: Se ç'vjen një si era mut këtu...*(kontrollon dyshtemenë me tufën e dritës)* Nga mund të vijë? Ke ndonjë ide ti, Bardhoshe?

ZONJA HELMIRË: Siç thua dhe ti, e bukura ime, këtu kutërbon *(ajo zë hundën me dorë)*. Duhet të ketë minj kanalesh nëpër tuba.

Argjendari nxjerr gjerdanin nga peshtafi dhe shkon drejt Kamilës.

ARGJENDARI: Ëngjëlli im, pranoje këtë, si një provë dashurie...

KAMILA: *(sallës)* Ai ka luajtur! Ai kërkon që unë të pres fytin!

ARGJENDARI: *(sallës)* Ajo nuk pranon një stoli që do ta fisnikëronte, kur ia ka hipur gjysma e Parisit!

KAMILA: Do të isha më modeste!

ZONJA LEOPARD: Kjo, mos është një...

KAMILA: Një prosti e vërtetë!

Ajo e hedh dritën e elektrikut të dorës mbi fytyrën e saj.

GRUAJA LEOPARD: Kohë më kohë ai arratisëj, ua mbathte në Marsejë *(pushim)*. Ai thoshte se prostitutat u ngjanin ca fluturave të ngulura në gjilpërë. Kjo e

frymëzonte... Midis tyre ai filloi një varg pikturash, të cilave u vuri titullin "Këmba e shtrirë". Me emrin e fluturës së natës.

Pushim. Zonja Helmirë ka filluar përsëri të punojë trikon. Ajo punon me shpinë të mbështetur pas çentralit. Në kabinën telefonike Djaloshi rrëmon nëpër xhepa. Gruaja Leopard pin. Argjendari, me pamje të menduar, përkëdhel gjerdanin. Kamila këndon duke rrotulluar unazën përreth gjilpërës së flokëve.

KAMILA: Kur bukuroshja ime dëshironte
Një gjerdan ari me rrezëllime marramendëse
Qafën e brishtë me të të rrethonte
Kur bukuroshja ime dëshironte
Unë i bëja një varg siç e donte
Me xixëllonja farfuritëse
Kur bukuroshja ime dëshironte
Një gjerdan ari me rrezëllime marramendëse.

ARGJENDARI: Mjaft! Mjaft këndove! Mbylle gojën menjëherë! Ky zë më bën të çmendem!

Një pushim gjatë të cilit dëgjohen vetëm shtizat e zonjës Helmirë duke punuar trikon dhe vërshëllima e pandërprerë e galexhantit...Kamila vërtit gjilpërën e flokëve dhe dëgjohet tringëllima e unazës, që bie mbi pllakat e dyshemesë.

KAMILA: (sallës) E dëgjuat? Si një monedhë që të bie nga xhepi (ajo fillon të kërkojë përtokë me tufën e elektrikut të dorës). Duhet të jetë rrokullisur këndeje, ose andej...Oh! Po sikur të ishte rrokullisur deri te pineta e të kishte rënë në vrimë? Çfarë fatkeqësie! Fatmirësisht ja tek është: mu në buzë! Oh, mjafton ta shtysh, fare pak, me majën e këmbës, dhe ajo do të zhduket.

ARGJENDARI: Ashtu u bëftë, jepi!

Kamila afron këmbën. Në të njëjtën kohë Djaloshi del nga kabina telefonike dhe qëndron përpara Argjendarit.

DJALOSHI: Dëgjoni, zotëri, ju do të thoni se unë po i fus hundët aty ku nuk më takon. Në të vërtetë, unë nuk e di emrin tuaj, as ju timin. Siç është pranuar të thuhet, ne jemi për njëri - tjetrin dy të huaj. Megjithatë, për shkak të një kombinimi rrethanash shumë të ngatërruara, që unë tani nuk jam në gjendje t'i

shpjegoj, brenda disa çastesh mësova për jetën tuaj më shumë nga ç'kam mësuar për mikun tim më të mirë për tetë vjet radhazi!

ARGJENDARI: *(sallës)* Do doja të kisha një djalë si ky, plot vrull, bujar, të guximshëm, që i përbuz rreziqet: një turbullues! Por natyra mosmirënjohëse më ka dhënë vetëm dy vajza: të bukura ç'është e vërteta, duhet thënë kjo, por teveqelet si e ëma, të pangopura si ajo, të sërta si ajo, të thata, lakmitare, të ngrira si bishta lopate... Një Trinitet i shenjtë femrash, ky është fati im, femra që e kalojnë kohën duke soditur para pasqyrës piçkat e tyre, cicat, kërthizën, duke pritur që unë të ngordh, duke pritur të marrin pasurinë... *(ai vendos dorën midis shalëve, peshon hallatet)*. Por pasuria është këtu dhe ato s'do ta marrin dot. Do të iki bashkë me të...

DJALOSHI: Tekefundit... A ka patur një ditë për ju ndonjë domethënie kjo unazë?

ARGJENDARI: Unë nuk shoh asgjë tjetër më të pabesë së kujtesa kur ajo dëshiron të jetë e tillë

DJALOSHI: Sidoqoftë, ju s'keni të drejtë ta lini të zhduket në një gjiriz, e shtyrë nga këmba e një lavireje!

ARGJENDARI: Në emër të kujt flet ky?

KAMILA: Të moralit *(ajo e shtyn unazën në vrimë)* Ekzekutim i njëzet e tre vjetëve mërzi. Gënjeshtër dhe marifete të tjera të ndyra: dënim me mbytje! Bert, në thelb unë të dua shumë, në një kuptim ti ke diçka në bark.

Djaloshi përplas kokën te dera e kabinës telefonike numer 2.

DJALOSHI: Gjithçka synon të na bëjë të humbasim arsyen: gjithçka!

AKTI III

Mbi tryezë gjenden të renditura katër shishe shampanje bosh. Në kova ka dy shishe të tjera të hapura. Zonja Helmirë është ulur në vendin e saj, ajo mban kapelen dhe mantonë e Gruas Leopard. Gruaja Leopard është ulur mbi tryezë, me shpinë të mbeshetur pas murit, ajo zbavitet duke afruar këmbën e saj të zbathur sa të jetë e mundur më afër një qiriri të sapondezur. Djaloshi është ulur mbi fronin e kabinës telefonike, dera e së cilës është e hapur krejt. Ai ka një qëndrim shumë të rreptë, të thuash se i përqëndron të gjitha forcat për të mos u lëkundur. Argjendari është ulur mbi legenin e nevojtores, dera e së cilës është e hapur krejt. Ai tymos një puro duke vështruar Kamilën, e cila kërcen një lloj vals. Kohë më kohë ajo ndriçon fytyrën e saj me elektrikun e dorës. Rreth qafës mban një gjerdan me diamante dhe rubinë, të cilët i përkëdhel duke kënduar.

KAMILA: Kur bukuroshja ime dëshironte
Një gjerdan ari me rrezëllime marramendëse
Qafën e brishtë me të të rrethonte
Kur bukuroshja ime dëshironte...

ARGJENDARI: Helmirë, zemra, më thuaj, a është gjithçka në rregull atje lart? Janë mbyllur dyert? Do të na shqetësojë njeri?

ZONJA HELMIRË: Unë madje kam vënë alarmin, si dikur, në kohët e bukura.

ARGJENDARI: Alarmin kur s'ka korent? E thashë, është gdhë fare kjo!

GRUAJA LEOPARD: (Zonjës Helmirë) E tij është kafeneja?

ZONJA HELMIRË: Prindërit e tij ishin tregtarë vere, por të klasit të lartë! Mendoni, përveç kafenesë, që ta themi midis nesh, do t'i sjellë atij një grusht të mirë me para, ata i kanë lënë edhe nje berrari në Truvil, apo Dovil... Ah, gjithmonë i ngatërroj!

ARGJENDARI: Në Honflër! Atje mund të shijosh midhjet më të mira të Bregut të lulëzuar!

KAMILA: (*me zë lutës*) Sikur të na çosh atje të gjithëve, Bert! Po të marrim trenin e parë, mund të kalojmë atje gjithë të shtunën dhe të djelën... Sa do të doja ta shihja detin edhe një herë!

ARGJENDARI: Mund ta shohësh gjithë jetën, shqerrka ime, gjithë jetën.

Kamila e hedh dritën e elektrikut të orës mbi Argjendarin

KAMILA: Mos bëj premtime që nuk mund t'i mbash: është e pandershme!

GRUAJA LEOPARD: Ajo ka të drejtë. Më shumë nga të gjitha të dhëmbin premtimet që nuk mbahen. (*pushim*) Ai më kishte premtuar se do të bënte me mua një fëmijë... Vitet kaluan. Për të kjo vazhdon të jetë e mundur edhe sot, për mua, jo më... Po i afrohem, siç thuhet, thyerjes së moshës! Ah, ç'fjalë të tmerrshme: të thuash se rinia jonë do të na fundosë. Por është shpejt, shumë shpejt!

ZONJA HELMIRË: Vajza ime thotë të njëjtën gjë. (*ajo përkëdhel këmbën e gruas Leopard*). Mos e çaj kokën moj bijë, ti je ende e bukur, e shëndetshme dhe sa për zorraxhinj, gjen sa të duash.

Gruaja Leopard tërheq këmbën befasisht.

GRUAJA LEOPARD: Dogja çorapen!

DJALOSHI: Nuk mund ta provoni dhe një herë?... Një herë të fundit?

ZONJA HELMIRË: E kam mbaruar ditën time të punës prej... (*sheh orën e dorës*) ekzaktësisht prej tridhjetë e tre minutash: tridhjetë e tre... Nesër! Nesër mund të bëjmë ç'të duash, biri im.

KAMILA: Kam ca të prera, poshtë barkut: të forta!

ARGJENDARI: Shqerrkë, vetëm martesë do të t'i qetësoje vezoret.

GRUAJA LEOPARD: Si rastësisht, mua s'më kanë ardhur prej tre muajsh... Mos ndoshta është zvjerdhur nga kjo ai? Është e vërtetë, seç ka një si vdekje që ngjizet brenda teje; gjaku që pushon së rrjedhuri... E megjithatë duhej të ndodhte e kundërta... Jo të zvjerdhej...

KAMILA: Kur unë heq fitilin prej sfungjeri, bideja mbushet me vizatime. Kam përshtypjen se lëkura më kthehet së prapthi: sikur i ngjitet gurit...

ARGJENDARI: Requiem aeternam dona eis.

DJALOSHI: Ju lutem.

Argjendari ngrihet.

ARGJENDARI: Çfarë?Çfarë do më ai? S'paskan të mbaruar lutjet?.. E pra, tashmë s'jeni më ai që ishit, keni ndryshuar. Në disa rrethana koha kalon shpejt dhe tashmë ju nuk jeni me aq krenar sa para pak çastesh (*ai merr një shishe shampanje dhe shkon drejt kabinës telefonike*). Përveç faktit që t'ju mbush dhe një gotë me këtë pije të shkëlqyer, a shihni ju, miku im riosh, se si mund t'ju ndihmoj për ndonjë gjë?

DJALOSHI: Jo, nuk shoh.

ARGJENDARI: E çuditshme, mund të thuhet se as ky, as ajo zonja nuk shohin më. (*ai i drejtohet sallës*) Përveç meje, a ndodhet këtu dikush që sheh?

KAMILA: Shoh unë, dhe shoh gjithnjë e më shumë se si po zbrazem çdo muaj... Dhe pyes veten, ku do ta gjej gjakun për të jetuar më tej. Të thuash se, po, po, kështu është, të thuash se prej disa kohësh unë bart një vampir.

ARGJENDARI: Duhet te të varësh qafë një dordolec për të prishur syrin e keq, shqerrka ime.

DJALOSHI: Ju jeni një harbut! Një...

ARGJENDARI: Ndërsa ju një personi mbajtur, dukeni nga pamja, megjithëse mëngët dhe jaka e këmishës suaj lënë për të dëshiruar. Por le t'ia hedhim fajin për këtë orës së vonë. Sa për këpucët (*ai qesh*) s' ke ç'u thua hiç, megjithë shiun: duket se i keni lyer këtë mëngjes...Por ngrijini pak këmbët.

Djaloshi i mbledh këmbët nën fron.

DJALOSHI: Mos jeni gjë i sëmurë?

ARGJENDARI: Në fillim molë, pastaj harbut dhe, për ta mbyllur, i sëmurë. Po nderohem ca si tepër! Molë, harbut, i sëmurë! (*pushim*) Harbuti me molë të sëmurë! Ky jam unë, unë jam...(qesh)

ZONJA HELMIRË DHE GRUAJA LEOPARD: (*së bashku*) Harbuti me molë të sëmurë!

ARGJENDARI: Sholla e këpucëve tuaja është e ngrënë. Këpucët i keni me karton. Guxoni të thoni se unë gabohem dhe do t'ju zbath publikisht. Sa kohë keni pa bërë një dush?

Zonja Helmirë me një rënë dorë përkëdhel në drejtimin e kundërt anët e prapme të mantosë dhe me tjetrën gjurin e Gruas Leopard.

ZONJA HELMIRË: Ai synon ta bëjë të qajë dhe do ta shihni, ka për t'ia arritur qëllimit.

ARGJENDARI: Dyzet e tetë orë? Tri javë? Në një çast të dhënë era është po ajo: njeriu kutërbon, kjo është e gjitha! (*pushim*) Si keni zbarkuar këtu, këtë natë? Përgjigjuni, ndryshe thërras policinë, të vijë t'ju ndalojë si rrugaç; nuk keni asnjë grosh në xhep. As mos e çoni nëpër mend t'ua mbathni. Të gjitha daljet janë të mbyllura! Ndërsa te dera e madhe ka rojë.

DJALOSHI: (*me fytyrë të kthyer nga telefoni*) Unë s' kam ndërmend t' ua mbath për arsye e thjeshtë se s'kam ku të flej...Në të vërtetë, ju mund të bëni që të më ndalojnë si rrugaç...

ARGJENDARI: Mos dredhoni, përgjigjuni pyetjes që ju bëra!

KAMILA: Kujdes, mor kolopuç, nëse vazhdon të sillesh keq me të, unë ua mbath dhe e marr me vete, kështu së paku ai do të ketë ku të flejë. (*Djaloshit*) A të vjen për mbarë ta kalosh pjesën që mbetet të natës në një bordell? Sigurisht, e keni parasysh, me atë bylmet, ai stan mban erë të keqe, por midis tij dhe metrosë...Pastaj, gjithçka do të shkojë në mënyrë të ndershme: secili në qoshen e vet. Sepse, sa për sqarim, kur marifetet e garipëve më çajnë bythën, unë ua nxjerr për hundësh.

ZONJA HELMIRË: Mos u nxeh moj ëmbëlsirë.

ARGJENDARI: Vërtet, shqerrka ime, pse e prish gjakun? Dhe ç'janë këto fjalë kaba në gojën tënde të vogël? Mendo: Sent-Ëstash,ti krejt në të bardha, një organo...

GRUAJA LEOPARD: Besoj se ai shkonte në bordell, madje jam e sigurtë që shkonte! Sepse kishte disa netë kur megjithëse bëja çmos për ta sjellë në qejf, ai më rrinte midis krahëve i flashkët: krejt i flashkët, si një trup i vdekur...

KAMILA: Atëherë?

DJALOSHI: Pelqej më shumë metronë.

ARGJENDARI: E sheh ku të çon zemra jote e madhe?

KAMILA: Ty unë të bëj shurrën te shtegu i flokëve për të të larë qyngjet e kokës: thënë ndryshe, të bëj mutin!

ARGJENDARI: Mirë, mirë, shih si kërcen (*pushim*) Helmirë, zemra, jepi ca para këtij mikrobit për t'u kthyer në vrimën e vet: është një tip i trishtuar. Një

përzierje e përdëllimit fetar me marksizmin: Pëh! Gjithsesi, s'ka koqe, s'të bën dot asgjë...

ZONJA HELMIRË: Po ku t'i gjej paratë?

ARGJENDARI: Dhe pyet, kur mjafton të përkulet!

ZONJA HELMIRË: Sa?

Ajo përkulet dhe pret.

ARGJENDARI: Po themi dyqind, hajt, pra, treqind. Kjo do t'i lejojë atij te shkojë te dushet e bashkisë, të paguajë për të ngrënë dhe një birrë gjatë rrugës.

Zonja Helmirë mbledh në dysheme tri kartëmonedha. Ajo i vendos mbi tryezë, nxjerr nga sirtari një kuti të rrumbullakët metalike ku ka pastilje për kollë dhe e përdor me kujdes për t'i shtrirë kartëmonedhat njëra pas tjetrës, duke i mëshuar në qoshe. Kamila e ndriçon me elektrikun e dorës.

ZONJA HELMIRË: Ja, ato janë si të reja.

KAMILA: Lërmë t'u marr erë. (zë hundën me dorë) Vërtet, mbajnë erë të re.

ZONJA LEOPARD: Më duhet të zbrazem, t'i nxjerr të gjitha: e ka fajin shampanja, mërzia...

Gruaja Leopard dhe zonja Helmirë ecin se bashku, ngjitur me njëra - tjetrën, pastaj ndahen, njëra shkon duke iu marrë këmbët drejt nevojtores, tjetra, duke i hequr këmbët zvarrë, drejt kabinës telefonike.

ZONJA LEOPARD: Më duket se që nga vdekja e mamasë, nuk kam vuajtur kurrë kështu (ajo përvesh fustanin). Më dhemb i gjithë trupi.

ZONJA HELMIRË: Mos e ka zënë gjumi këtu? Me gjithë atë të pirë që bëri...nuk lëviz fare...

ARGJENDARI: Vërja këto te parvazi, pastaj mbyll derën.

ZONJA HELMIRË: Do të jetë një befasi e këndshme për të!

Kamila, duke ardhur rrotull, shtyn me këmbë derën e nevojtores. Dëgjohet urinimi i Gruas Leopard, pastaj dhe zhurma të tjera intime. Argjendari shkon e vjen duke lëshuar drejt tavanit tymin e një puroje që sapo e ka ndezur. Kamila ndriçon shtëllungat e tymit.

ARGJENDARI: E gjithë kjo më kujton punishten e lëngut të mollëve... Era, mizat, zhurmërima e frutit që plasaritet nën diell, çarja nën brymë... Krahu im i palëvizshëm në anë të dritares, dora duke kulluar nga kënaqësia e masturbimit

tim të parë. Një kënaqësi ngjitëse. Komposto në shkretëtirë... Mizat. Era e kalbësirës. Dora ime, palloshi im në zbrazëtinë e dorës. Mizat...

KAMILA: Nëna ime thoshte: jeta është një mut me majë. A ma shpjegon dot këtë, Bert? Kam aq shumë nevojë për të kuptuar.

ARGJENDARI: Më është bërë dru: shqerrkë, je e hatashme!

KAMILA: Qeni që leh nuk të kafshon, thoshte im atë. A ma shpjegon dot këtë, Bert? Kam aq shumë nevojë për të kuptuar.

Dëgjohet Gruaja Leopard që vjell. Zonja Helmirë mbyll derën e kabinës telefonike.

ZONJA HELMIRE: *(me gishtin te buzët)* Po flen.

ARGJENDARI: Mor po sa e mallëngjyer është!

Pushim. Gruaja Leopard del nga nevojtorja duke fshirë buzët me fundin e fustanit. Rimeli i ka kulluar, mbi faqe ka vija të gjata, të zeza.

GRUAJA LEOPARD: Më zuri frika! M'u duk sikur po më shihte ai që, kur qaja, më thoshte: Mos qaj. Ti nuk je hiçgjë, meqë lëkura jote është e domosdoshme për përzierjen e ngjyrave të mija... *(ajo i afrohet tryezës dhe i hap duart pranë flakës së qiririt)* Kam_ftohtë...

ZONJA HELMIRË: Merreni mantonë!

GRUAJA LEOPARD: Të marrësh atë që ke dhënë, është vjedhje natën me hënë. Kështu thonim dikur në shkollë... Sa e largët ajo kohë...

ZONJA HELMIRË: E di se me këtë do të ngjall shumë zilira. Por, pa shaka, vërtet ma falni?

Argjendari ia bën me shenjë zonjës Helmirë të heshtë.

GRUAJA LEOPARD: Unë nuk do të shkoj të mbytem bashkë me të! Ha! Farsa e bukur që do të luaj unë për artistin, duke marrë përjetësisht me vete paletën ku ai përzierte ngjyrat siç ia donte qejfi.

ARGJENDARI: Por paleta gjen sa të duas ama, edhe prej fajance...

ZONJA HELMIRE: Kjo duhet lagur!

KAMILA: Çfarë duhet lagur akoma?

ARGJENDARI: Vendimi i urtë i zonjës që, kur të dalë prej këndeje, të shkojë të mbytet. Pastaj Helmira, shërbyesja jonë Helmirë, e shpallur për elegancën e saj si zonja e parë çiqi e Parisit. Dhe trapi im, që ngrihet kur sheh prapanicën e saj të madhe, mbuluar me lëkurë leopardi.

GRUAJA LEOPARD: Është lëkurë pantere, nga Somalia...

ARGJENDARI: Rrotullohu, Helmirë, ec atje, duke u përdredhur pak, ah, po, ah, po!
Merre pak vogëlushen në krahet e tu... Po lëre veten të lirë, shqerrka ime, bëhu me e shkathët... Rrotullohuni të dyja, kështu, rrotullohuni!. Këndo, shqerrka ime, këndo!

KAMILA: Më dashuronin... Isha e adhuruar
Sepse kisha gjithçka duhet për t'u pëlqyer
Vështrimin shpuzë dhe provokues

GRUAJA LEOPARD: Edhe unë dua të kërcej.

Ajo i ndan Kamilën dhe Helmirën, e zë secilën prej tyre prej qafe.

ARGJENDARI: *(duke iu afruar fundit të shkallës)* Mackat e mija, mos lëvizni, mbi të gjitha mos lëvizni. *(duke vënë duart pranë gojës për të forcuar zërin, ai bërtet)* Luis, dy shishe të tjera! *(pushim)* Epo mirë, pra, si duhet t'jua shpjegoj? Mos më thoni se atë hajvan e ka zënë gjumi!

Ai zhduket nëpër shkallë, duke u ngjitur me vrap.

GRUAJA LEOPARD: Musica, musica...

ARGJENDARI: Sikur të isha Zot! *(dëgjohet zhurma e një karrigeje që përmbysset.)*
Ah, punë muti!

KAMILA: *(Gruas Leopard)* Harruat se nuk kemi drita?

ZONJA HELMIRË: Është një ndërprerje e gjatë, si herën e fundit.

GRUAJA LEOPARD: Pse nuk ngjitemi lart? Këtu të zihet fryma.

KAMILA: Mua, përkundrazi, fryma më zihet atje lart, jashtë strehimit. Pastaj, netët ne i mbyllim këtu, të gjitha netët. Madje vitin e kaluar, festuam këtu dhe Vitin e Ri. Të kujtohet Bardhoshe?

ZONJA HELMIRE: Po, po, ka qenë ndër më të bukurit e jetës sime. Edhe vajzai me ishte me ne, i kishte hyrë në qejf një zhulsi. Një këllire që i këndonte në vesh, duke e përkundur: *(ajo këndon)*

Po bien violinat... Mari

Shko vogëlushe, sa më pëlqeje ti.

KAMILA: Atje kishim vendosur bredhin... *(tregon nevojtoeren)*. Brenda në ndenjësë, në një kovë shampanje. Ti kishe përgatitur borë me copëra te vogla

pambuku,të kujtohet? Sa herë që zbriste ndonjë tip ose ndonjë vajzë, u duhej ta ngrinin bredhin, pastaj ta vendosnin përsëri. Ç'qyfyre kemi bërë! Kishte nga ata që shurrnin duke e mbajtur bredhin në krahë. Për të gjithë pjesëmarrësit shpërndaheshin çokollata, mandarina kokërr vogla ndërsa për të pirë kishte sa të fryje trutë për të gjithë zhulësat. Çfarë feste!

Pushim. Djaloshi shfaqet te pragu i kabinës telefonike, duke qeshur.

DJALOSHI: Zonjusha zuri në gojë strehimet. *(ai tregon me gisht Kamilën duke qeshur me të madhe)* Strehime: vërtet, ja një pjesë e zgjidhjes! Sepse ja kush do ta përthithte një pjesë të papunësisë...Në të gjitha kohërat, dhe me të drejtë, njerëzit i janë trembur luftës, por sot, kur i dëgjon, duket se ata kanë rënë pre e një psikoze të vërtetë. *(ai zgërdhiet)* Pra, ky do të ishte një çast i zgjedhur mirë për t'u ndërtuar atyre strehime... meqë tek ne, lidhur me strehimet, kemi mbetur te bodrumet e pashëndetshme, gati në të shembur. *(një shpërthim tjetër të qeshure)* Por, nëse propozimi im do të dëgjohej, mos ndoshta nuk do të pritej aspak mirë? Në të vërtetë atje lart mendojnë se është më e pëlqyeshme të mbahen njerëzit me frikë ...Frika të paralizon. Pengon veprimin. E ndalon atë...Ç'vlerë ka të ndërmarrësh diçka? Përderisa nesër gjithçka do të hidhet në erë! Përkrahet më shumë pritja, pritja e më së keqes...Por më e keqja do të mbërrijë. Më e keqja mbërrin gjithmonë, duam apo s'duam...Ndërkaq ne nuk do të bëjmë asgjë: dhe më keq akoma, as që do të provojmë të bëjmë ndonjë gjë!...

ZONJA HELMIRË: Është e vërtetë që njerëzit votojnë gjithnjë e më pak, dhe nuk e kam fjalën për të rinjtë!

KAMILA: Unë, përshembull, nuk votoj, e pse të votoj? E majta, e djathta... e di njeri se kush do t'i mbyllë kupllaratë dhe do të mendojë për fatin e prostitutave? Askush nuk e di

DJALOSHI: Po ti, di ndonjë gjë?

KAMILA: Unë di se e djathta dhe e majta palloshin e kanë në qendër. *(ajo e vendos elektrikun e dorës në lartësinë e pubisit)* Kështu! Si një flamur rreth të cilit bashkohen të gjithë!

Me një goditje të befte të dorës Djaloshi i shpërndan në ajër kartëmonedhat e vendosura të parvazi në kabinë. Këto të fundit vërtiten në ajër, pastaj shpërndahen mbi dysheme,jashtë kabinës.

KAMILA: Paratë, aq të vështira për t'u fituar!

DJALOSHI: Mblidhini, ju që s'keni turp nga asgjë!

KAMILA: Si e gjeti ky? Është e vërtetë, unë e kam ngrënë turpin me bukë...

Ajo përkulet, mbledh kartëmonedhat, me të cilat bën fresk, duke rifilluar të këndojë.

KAMILA: Me një të puthur paguaja shpesh

Me rondelë ose baladë

Kur donin të më linin vërtet,

Me një të puthur paguaja shpesh

Kështu, pa e prekur kurrë

Qesen time gjithmonë të sëmurë...

Argjendari dhe Kamerieri, që kanë ndaluar të shkallarja e fundit, mbajnë në dorë secili nga një shishe shampanje.

ARGJENDARI: Ajo është gjithmonë kështu, kaq e gjallë!

KAMERIERI: Kaq e gjallë dhe kaq e freskët.

KAMILA: Sepse lahem çdo ditë me shampon e guajtur spermë.

ZONJA LEOPARD: Ai më ka thënë se isha e mplakur dhe më vareshin tulet... Mua, dyzet e katër vjeçe, pa asnjë rrudhë! Notare. Trupi im është si i paprekur... Të thuash se nuk i operova kofshët për t'i pëlqyer atij... Me muaj pa u ulur, duke qarë... Me javë në këmbë, për t'i pëlqyer atij... *(ajo i afrohet Argjendarit)* Bert, më deh!

ARGJENDARI: S'ka gjë më të lehtë *(ai e vendos shishen mbi tryezë)*. Helmirë, zemra, ki mirësinë, na e hap këtë shishen.

KAMERIERI: *(duke iu afruar tryezës)* T'i hapim bashkë, Helmirë, do të kërcasin me fort, pastaj do të kem përshtypjen se jam i vlefshëm.

ZONJA HELMIRË: Pa dashur të kundërshtoj askënd... *(ajo rreket të hapë shishen. Kamerieri bën të njëjtën gjë)*... nëqoftëse plas ndonjë luftë, ta themi midis nesh, për çfarë do të shërbente strehimi? Do t'i lëshojnë një bombë dhe pastaj... *(tapat kërcëjnë përpjetë)* Vajza ime thotë se do të jetë si në Hiroshima, po kësaj radhe më e tmerrshme...

KAMERIERI: Çfarë spektakli! Po rri e qetë moj Helmirë, kjo nuk do të ndodhë më... Tmerri ka kufijtë e vet! *(pushim)* Megjithëse në thelb kësaj nuk i dihet.

Me gjithë ato marifete që kurdisen sot, planeti mund të na pjerdhë te hunda...*(Kamerieri zë hundën me dorë)*. Dhe, më besoni, atë ditë do vijë erë e keqe!

Pushim. Dhe të gjithë vështrojnë Kamerierin, i cili, duke ecur praptazi, shkon drejt shkallëve, ku ulet.

ARGJENDARI: Epo mirë, moj çupka, çka ndodhur? Deri tani ju ishit aq të lezetshme...Gjashtë këmbkat tuaja të bukura, tri pikat tuaja të bukura në tri breçka aq të ndryshme...Mos u trembët nga fjalët e Luisit? Apo midis nesh gjendet ndonjë ters që na prish humorin?

DJALOSHI: Po, ja tek jam, dora vetë!

ARGJENDARI: Pa shih! Prapë këtu qenka ky? Ne sikur ia dhamë ç'i duhej për t'u zhdukur. Hajt, bagëti, qërohu! Era e tij e prish erën hyjnore të punishtes së lëngut të mollëve, që unë përpiqem të rikrijoj këtu...Pa dyshim, ai kujdeset të mbajë pastër sqetullat, këmbët, kanotieren, fundin e brekëve. Dhe kokën e tij të vockël prej reformatori, që më duket si derr i egër kur më del përpara.

DJALOSHI: Po e pohoni se prania ime ju besdis...Pa mua do ta luanit më mirë rolin e kapadaiut mes këtyre të trejave!

GRUAJA LEOPARD: Ashtu si ju, edhe unë zbrita këtu për të telefonuar...*(ajo mbështetet pas zonjës Helmirë)*. E kam ditur gjithmonë se telefoni ishte një shpikje ogurzezë...

DJALOSHI: Dhe sa u laga unë për t'ju gjetur një taksì... Shiko, e harrova fare taksinë.

KAMILA: Mos e ça kokën, shoferi s'ka hedhur rrënjë. Dhe dëgjo, kur të realizohen ëndërrat e tua prej muratori, me dërgo një mandat-postë prej dhjetë frangash: kaq i dhashë shoferit për pritjen.

DJALOSHI: Por taksia nuk ishte për mua, unë nuk ju detyrohem për asgjë!

KAMILA: Hej! Ti atje lart fare, që e ke një përgjigje për gjithçka...*(ajo ndriçon tavanin)* A mund të më thuash, kush do të ma paguajë biletën që e kam fituar me djersën e piçkës sime?

GRUAJA LEOPARD: *(Zonjës Helmirë)* Ç'kërkon më ajo, me gjithë atë që ka rreth qafës?

ARGJENDARI: Durim, të dashurit e mi, durim! Mund të bëjmë shumë gjëra. Madje mund të bëjmë gjithçka, me kushtin e vetëm që të mos i hapim rrugë shpirtvogëlsisë. Të jemi shpirtmëdhenj, të dashurit e mi, shpirtmëdhenj, gjithmonë! Na duhet të japim prova për këtë, me qëllim që t'i lartësojmë sadopak jetët tona të ulëta. Këtë stoli e paguaj unë, me paratë e mija. Sa u përket dhjetë frangave që ka shpenzuar e fejuara ime, tregohuni e hirshme, zonja... meqë ra fjala, si ju quajnë? Harrova si ju quajnë...

ZONJA LEOPARD: Asgjë më.

ARGJENDARI: Pra, zonja Asgjëmë...

Pushim... Gruaja Leopard merr çantën mbi tryezë, e hap dhe nxjerr prej andej një kartëmonedhë njëqind frangëshe. Gjatë kohës që Argjendari mbush gotat, ajo ia zgjat Kamilës.

GRUAJA LEOPARD: Nuk kam të vogla.

KAMILA: Kam unë. *(Ajo hap çantën e saj prej nga nxjerr një tufë kartëmonedhash me prerje më të vogël dhe, me një përqëndrim të tepruar, i kthen Gruas Leopard nëntë kartëmonedha. Një pushim gjatë të cilit dy gratë vështrojnë njëra-tjetrën)* Mos ju dhemb që e shihni gjerdanin e gjyshe juaj në qafën e një lavireje?

GRUAJA LEOPARD: *(sallës)* Dhimbja më vjen ngaqë nuk e di më përse po ndahem nga ky gjerdan. Paratë nga shitja e kësaj stolie, do t'ia jepja atij. Ai dëshironte të shembte një nga muret e ateliesë, ta zëvendësonte me qelq: qelq një copë...Te kem dritë, thoshte, dritë. Duart plot me dritë. Më ndihmo të shpërndaj rreth meje duart e ngrira që kërkojnë të më burgosin. Më ndihmo. Më zihet fryma nga dorezat. Më zihet fryma nën një kapele. Më zihet fryma edhe nën një pallto kur bën ftohtë. Këmbët e mija ndihen gjithmonë ngushtë brenda këpucëve...Së shpejti do të më duhet të heq dorë nga këmisha: të dal lakuriq *(pushim.)* E ç'më duhen këto para tani?

ZONJA HELMIRË: Më duket sikur jam në ëndërr. *(ajo përkëdhel me majat e gishtave, në drejtimin e kundërt të qimeve, anën e prapme të mantosë.)* Kjo do të më mbajë ngrohtë këtë dimër. Të thonë sa të duan se njeriu mësohet me të ftohtin, mjaftojnë njëzet minuta në këmbë për të shkuar deri te autobusi, kur acari të pret...dhe bindesh se në periferi të ftohtë ia mbërrin më shpejt...

ARGJENDARI: Si është puna, zemra? E ke fjalën për autobusët? Unë kujtoja se ishte e kundërta! Po t'ua vësh veshin shitëseve të mija kur mbërrijnë me vonesë, fajin e ka gjithmonë ai drejt autobusi që vonohet pa fund... Kujt t'i besosh?

ZONJA HELMIRË: Po flisja për dimrin, zoti Bert. Dhe ju siguroj se këto që them nuk janë shaka, në periferi bën më ftohtë se këtu.

ARGJENDARI: *(sallës)* Ajo e sheh diskriminimin kudo!

DJALOSHI: Sepse ajo sheh qartë.

KAMERIERI: *(sallës)* E vetmja që sheh qartë këtu është Kamila! Ajo më ka marrë elektrikun e dorës. Ajo m'i merr të gjitha. Thotë se i sherbejnë gjatë natës. Unë vras mendjen të gjej përse i sherbejnë sepse, kur ajo nuk e kalon kohën këtu, e kalon nën dritën e ndonjë shtylle. Një herë, për t'u tallur me mua, më tha se me elektrikun e dorës ajo kërkonte të vërtetën... Ku e ke vënë, Kamilë?

KAMILA: *(duke e futur elektrikun e dorës nën dekolte. Këndon)*

Unë jam picirukja me cica të mëdha

Që ia hedhin në hava

Të gjitha kopsat e bluzës...

ARGJENDARI: Ajo s'ka idenë se sa e rëndësishme është. *(ai vërtitet rreth Kamilës, me gotën e ngritur perpjetë)* Nuk do t'ia dijë për bukurinë e saj, zërin, shpirtin që ka përbrenda... Shikojeni: ajo është e verbër.

GRUAJA LEOPARD: *(me një psherëtimë)* Siç kam qënë unë.

ZONJA HELMIRË: Si vajza ime. E dini ç'më tha sot? Dëgjojeni këtë, zoti Bert, dëgjoje, bukuroshja ime, dhe vini veshin mirë, tetë vjet pasi i kanë hequr gjirin, qafën e mitrës, një pjesë të madhe të organit, e mjera ajo, aty poshtë nuk ka më buzë! Ka një toptë nën gjuhë, në madhësinë e kokrrës së arrës. Dhe më thotë mama, është kanceroze.

Pushim. Kamila kërcen vals duke fërkuar te faqja gotën e saj të zbratur. Zonja Helmirë qan në heshtje. Zonja Leopard dënes e mbështetur pas murit. Kamerieri ka mbështetur kokën te gjunjët.

KAMILA: *(këndon më zë të butë)*

Po bien violinat...Mari

Shko vogëlushe, sa më pëlqeje ti

Unë s'kam më nevojë për asgjë

Shko të vallzosh në ajri

Po bien violinat...Mari!

DJALOSHI: *(duke e përplasur kokën dy herë pas parvazit në kabinë)* Ec e mos luaj mendsh!

KAMERIERI: *(duke ngritur kokën)* Po të isha në vendin tuaj, unë do t'ua mbathja...Këtu mund të ndodhë çdo gjë. *(Djaloshi zë veshët me duar. Pushim)*
Unë jam një përparëse: një përparëse që flet, të cilën nuk e dëgjon askush.

Argjendari shkon e vjen nëpër dhomë me puron e fikur midis buzëve.

ARGJENDARI: Në Honflër, u vendos, do t'ju çoj atje të gjithëve...Por me një kusht: të mos kemi lotë! Dhe mjaft me ankime *(pushim)* Luis,ti ishe me i lezetshëm kur piqe.

KAMERIERI: Nuk ma mban më të pij ,zoti Bert...

GRUAJA LEOPARD: Na flit edhe një herë për detin.

DJALOSHI: Ai jep urdhëra... Sillet si zot i plotfuqishëm i fateve tona, pa pyetur perse gjendemi ketu! *(ai kthen gotën)* Atij i duket krejt e natyrshme që ne i shkojmë pas si Jezu Krishtit. Por ai nuk do të ecë dot mbi ujë, nuk do të bëjë dot mrekullira. Paraja nuk mund t'i bëjë të gjitha. *(duke iu drejtuar Kamilës)*
Ai nuk mund t'jua kthejë pafajësinë tuaj!

KAMILA: Sidoqoftë, në djall pafajësia, si gjithë të tjerat.

ARGJENDARI: Ai është i shkëlqyer. Po të isha mbret,do ta merrja si gaztorin tim.
(duke i dhënë djaloshtit shampanjë) Na këtu, Gishto, pi!

Djaloshi e kthen gotën me një frymë dhe e afron përsëri gotën te gryka e shishes dhe argjendari ia mbush. Kështu, tri herë me radhë.

DJALOSHI: Mbretëresha do të binte në dashuri me mua në mënyrë të pashmangshme.

ARGJENDARI: Je tepër i vogël për këtë.

DJALOSHI: Mos jini kaq i sigurtë.

ARGJENDARI: Ç'kërkon të thotë ky?

KAMILA: Se ai nuk është ngordhalaq, se është i fortë.

ARGJENDARI: Pse, unë nuk jam i fortë? Kam kaluar tri herë sifilizin, e pastaj? (*ai godet me grusht gjoksin në lartësinë e portofolit*) Muskulin tim të gjithfuqishëm, unë e kam këtu!

DJALOSHI: Po të isha në vendin tuaj...(*qesh*)...Do t'ia ndryshoja anën: zemra ka dobësitë e veta.

ZONJA HELMIRË: Të paktën të ishim të sigurtë se do të shkonim atje lart...

ARGJENDARI: Më dëgjo mua... (*i afrohet zonjës Helmirë, i ngre mjekrën*) Nuk ka parajsë, zonja Çiçi!

Pushim. Gruaja Leopard mbyllet në nevojtoare. Argjendari i fshin fytyrën zonjës Helmirë me shaminë e tij dhe i pastron hundët.

ZONJA HELMIRË: Po më vrisni, zoti Bert, më dhemb!

ARGJENDARI: Mos e lësho veten, zemra, fryj pak...Ja, kështu...Po jo kaq fort! Hoola! Me tërë atë hundë që më ka, do të ma mbushë shamizën prej mëndafshi me një të fryrë!

KAMERIERI: (*duke u ngritur e duke i zgjatur përparësen*) Keni nevojë për ndihmë, zoti Bert?

ARGJENDARI: Oh, të lutem Luis, përmbahu. Të lutem, kthehu në vendin tënd.

KAMERIERI: (*duke kthyer shpinën*) Une s'desha të thosha se hunda jote është e madhe, Helmirë, ti e kuptove, apo jo?

Zonja Helmirë tund koken.

DJALOSHI: (*Kamilës*) Ketë këngën e fundit e këndonte edhe nëna ime.

KAMILA: Edhe imja, unë e mbaj mend prej saj...si gjithë të tjerat.

DJALOSHI: Por sot, përveç refrenit...

Pushim. Kamila, me një pamje të rëndë, ndriçon të katër qoshet e dhomës.

ARGJENDARI: Ajo bën sikur po kërkon diçka, kur të gjithë repertorin e saj e ka në kokë, e plot gjëra të tjera...Por ajo s'do t'ia dijë fare, shikojeni, është shurdhe. Shurdhe dhe e verbër!

KAMERIERI: (*në këmbë i mbështetur pas murit të shkallës*) Nuk është e vërtetë. (*Kamila e ndriçon*) Këndo, Kamilë, siç këndove një mbrëmje për endacakët e pastrëhë (*pushim*) Mjafton të sjellësh ndërmend fytyrat e tyre që të këndosh...Fytyrën time, të kujtohet, ti e ndriçove me shkrepëse, pastaj më the: Ti më sjell ndër mend një qen që kam pasur kur isha e vogël... Atë e shtypi

makina, më merr malli vazhdimisht për të, atëhere po të duash ta zëvendësosh...

KAMILA: *(me një rën dorë të mbështetur te korniza e derës së kabinës telefonike, me shumë se sa këndon, reciton)*

Tek korrnim grurin në muajin gusht
Po ngordhnim nga etja në fushë
Shkova të pija me trupin zhuritur
Te një burim, i rraskapitur
Uji i ftohtë m'i akulloi gjakrat
Dhe po vdes unë në këtë vjështë të butë
Kur rreth fuçisë seç hidhet vallja
Këto ditë të bukura që po marrin fund

Kamila futet në kabinën tekefonike.

KAMILA DHE DJALOSHI: *(në duet)*

Po bien violinat Mari
Shko vogëlushe sa më pëlqeje ti
Unë s'kam më nevojë për asgjë!
Shko të vallëzosh në ajri...

ARGJENDARI: *(Zonjës Helmirë)* Vështro atje! Ajo i pa të gjitha dhe e lë veten të ngashnjehet, siç do të bënte një çupëlinë mendjefyçkë...Ti, zemra, e kupton se të ngjashmit e mi më neverisin *(pushim.)* Megjithatë, unë e paralajmërova, i thashë dhe asaj: nuk ka ndonjë parajsë përveç asaj që i krijojmë vetes. Po kujt t'i flasësh? Njëlloj si të kisha lëshuar një glasë: fjalët e mija nga një vesh i hynë, nga tjetri i dolën...Atë do ta dëpërtojë organi i atij karagjozit, për një çast ai do t'i krijojë përshtypjen e një rilindjeje...Dhe ndoshta është ky çast që ka rëndësi, kur e tërë qenia i shkëputet kohës. *(një psherëtimë)* E keqja është se ajo do të vazhdojë ta kërkojë këtë, shpirti i saj i thjeshtë ka nevojë për një kënaqësi jetëgjatë.

ZONJA HELMIRE: Po sikur ata të dashuroheshin?

KAMERIERI: Po, sikur të dashuroheshin...

ARGJENDARI: Oh, ju lutem, t'i lëmë fjalët e mëdha. Pastaj, miqtë e mi, ajo është e njollosur. Kush do ta donte atë, përveç një të çmenduri si unë? Rinia do të fluturojë, bashkë me të dhe bukuria, dhe shpejt, në atë tren ku ajo ka hipur...Atëherë do të mbetet vetëm fishkja. *(ai e flak puron dhe i drejtohet sallës)* E kush i do gjërat e fishkura? *(psherëtin)* Askush!

Dera e WC-së hapet dhe shfaqet gruaja Leopard. Ajo ka larë fytyrën, nuk ka më gjurmë makiazihi. Flokët i ka thurur në një gërshet të vetëm dhe nuk mban më asnjë stoli.

GRUAJA LEOPARD: *(duke u mbështetur pas murit)* Jam gati.

ARGJENDARI: Për çfarë?

GRUAJA LEOPARD: Ju folët për një udhëtim...

ARGJENDARI: Sigurisht, por treni i parë nis vetëm në orën shtatë e dy minuta *(ai ngre manshetën e djathtë)* Kamilë, picirukja ime, sa është ora të lutem?

Koka e Kamilës shfaqet jashtë kabinës telefonike.

KAMILA: Ora folëse e murit nuk përgjigjet më... Mekanizmin e saj e prishën ca vandalë. Plasi edhe një bombë tjetër!

ARGJENDARI: Ke vendosur të më dalësh nga zemra?

KAMILA: Unë?

ARGJENDARI: Ti kujton se unë do ta humb kohën duke u folur mureve? Çfarë po pret atje brenda?

KAMILA: Asgjë.

ARGJENDARI: Natyrisht. Atëherë, shqerrka ime, dil! Na mbeten për të vrarë, po them, një çift orësh, dy orë të vogla, para se të rrokullisemi drejt detit. Mbushe të paktën njëren nga këto orë duke na treguar se si e ke kaluar ditën sot...

GRUAJA LEOPARD: Të ketë vajtur ora pesë?

ZONJA HELMIRË: Shkalla është krejt e errët... Sipas meje, duhet të jetë më shumë aty rreth ores tre.

KAMERIERI: Unë do të thoja më shumë tre e gjysmë apo katër pa një çerek. Nga vendi im gjërat shihen më mirë.

Argjendari bën një gjest me dorë, për të treguar se kjo nuk ka kurrfarë rëndësie.

GRUAJA LEOPARD: Në të vërtetë ç'rëndësi ka në është ora tre apo katër...Sipër kokës së krevatit tonë gjendet një merimangë që end pëlhurën e saj midis dy

trarëve (*pushim*) Ai duhet të jetë duke vështruar merimangën... Ai mund të rrijë me orë duke e vështruar. Nëse unë e pyes: Çfarë po mendon? Ai përgjigjet: Mos bëj pyetje të rrezikshme.

KAMERIERI: (*me vete*) A e di ajo se sa të drejtë ka ai?

Kamila del nga kabina telefonike, e ndjekur nga djaloshi me flokë të shpupurisura, që mbahet në këmbë me vështirësi.

DJALOSHI: Ai ka të drejtë! Besoni ju se njeriu mund të ndërhyjë në rrjedhën e mendimit të tjetrit, dhe t'ia ndërpresë duke e pyetur me një ton që kërkon të vërtetën: "Çfarë mendon ti?", e kjo pa rrezikuar? Po sikur tjetri befas të përgjigjet duke thënë pikërisht të vërtetën: Dëshira është një ndjenjë fluturake që unë e kam provuar për ty më parë duke të vështruar të shfaqesh në tavanin prej paqsyre të Kafesë së Madhe... kjo ishte drita e fortë e llampave në tavanet e veturave mbi krahët e tu të zhveshur, veshja jote ekstravagante, pesha e lodhjes që i mbështillte ende supet e tu, lutja gjëmimtare brenda teje, e cila, megjithatë, nuk arrinte t'i bashkonte dy duart e tua që ti i mbaje grusht, larg njëra-tjetrës dhe si gati për t'u ndeshur, harku i vetullave të tua të prishura, që i jepte ballit tënd një përshtypje pafundësie, panorame, ku e pashë veten farë të vogël duke ecur në anë të qepallave të tua...Unë vendosa majën e këmbës sime mbi beben e syrit tënd për të ta errur syrin dhe kjo të bëri të ngrije kokën. Ti më pe. Ne u vështruam dhe unë pata dëshirën ta përdorja trupin tënd si makinën më të përsosur, me të aftën për të dhënë kënaqësi... Këtë pashë unë tek ti, asgjë tjetër! Diçka te e cila unë mund të shterem...

Djaloshi vjen rrotull rreth Kamilës, e cila i ndriçon fytyrën.

KAMILA: Në orën dymbëdhjetë fiks, siç e kam zakon qysh prej një viti, gjendesha në qoshen midis rrugës së Arinjve dhe rrugës Kenkampua. Një vend për të cilin kam luftuar dhe e kam paguar shtrenjtë, por kam bërë mirë, sepse është një vend i mirë. Tashmë klienti im ndodhej atje, i përpiktë si gjithmonë. Një tip nga televizioni, të cilit i intereson jeta e kafshëve. U ngjiëm lart. Më dymbëdhjetë e një çerek unë gjendesha përsëri në qoshen midis rrugës së Arinjve dhe rrugës Kenkampua. Atje më priste një klient i rregullt. U ngjita lart. Më dymbëdhjetë e njëzet e pesë, me një qind e pesëdhjetë franga në çantë, unë gjendesha përsëri në qoshen midis rrugës së Arinjve dhe rrugës Kenkampua. Kalon një shtrembaluq, unë e mbërthej duke ia vënë dorën te

vendi. Ngjitemi... Më dymbëdhjetë pa një çerek të natës kam ca si miza nën vete, një ënjtje midis këmbëve, që më detyron t'i mbaj të hapura. Mbërrin një derdimen, me një qese plastike në secilën dorë...

Pushim. Zonja Helmirë hap sirtarin, prej nga nxjerr dy qese plastike, të cilat ia zgjat Argjendarit. Kamila ndriçon dyshtemenë me elektrikun e dorës. Argjendari ngre jakën e xhaketes dhe mbështillet me të. Djaloshi zbrapset në kabinën telefonike. Gruaja Leopard qëndron e palëvizshme, mbështetur pas murit, me krahët në formë kryqi, si një flutur e kryqëzuar. Kamerieri ngre perparësen, mbulon kokën me të dhe qëndron i palëvizshëm, me krahët përgjatë trupit. Argjendari, i përkulur lehtë, kalon dhe rikalon përpara Kamilës, e cila është mbështetur me shpinë në këndin e murit.

ARGJENDARI: (duke ndaluar para Kamilës) Më fal, unë kërkoj kullën Sen-zhak...

KAMILA: (duke e çuar tufën e elektrikut të dorës në drejtim të Kamerierit) Ec përpara, drejt.

Argjendari shkon deri te shkalla, pastaj kthehet mbrapsht.

ARGJENDARI: (duke ndaluar në lartësinë e Kamilës) Ka shumë shkallë për të ngjitur?

KAMILA: Si për t'u ngjitur deri në qiell.

Kamerieri zbrapset me një shkallare.

ARGJENDARI: (duke kryqëzuar e çkryqëzuar krahët pas shpine, dëgjohe fërkimi i qeseve plastike) Ti... Ti je e bukur si engjëll...

Argjendari vështron tinëzisht rreth vetes, pastaj qëndron për një çast me kokën e kthyer nga publiku, të cilin e vështron me ngulm, dhe shkon pas Kamilës.

KAMILA: (duke kaluar përpara tryezës pas së cilës është ulur zonja Helmirë) Dhomën do t'ju paguaj kur të zbres. Eshte tip i druajtur.

Ajo e vendos elektrikun e dorës mbi tryezë dhe ngjit tre shkallaret e para të shkallës. Argjendari e ndjek nga pas. Kamila ndalon te shkallarja e katërt dhe zgjat krahun në errësirë.

ARGJENDARI: Të lutem, mos bëj dritë. Drita elektrike është e tmerrshme... Vëri duart mbi sytë e mi.

Kamila i vendos duart mbi sytë e Argjendarit, i cili lëviz qeset plastike pas shpinës.

KAMILA: Janë të ngrohtë... Syte e tu janë në ngrohtë.

ARGJENDARI: Tani i ndiej kokërdhokët... i ndien ti?

KAMILA: I ndiej

ARGJENDARI: Ma trego që i ndien duke i rrethuar... Ja (*pushim*) Përmes tyre ka depërtuar drita elektrike për të ndriçuar brendësinë e kafkës sime, për të zbuluar faqe gjithë botës të fshehtat që ruaja aty. (*fërkimit të qeseve plastike ia zënë vendin ca dihatje*) Këtë natë ti do të flesh me një njeri të poshtër. Një tradhëtar. Një qenie të ulët, që nuk i bëri dot ballë torturës: një spiun! A pranon? Ka ende kohë për të thënë jo...

Kamila qëndron drejt, me krahët përgjatë trupit, fytyra e saj ka marrë pamje të rëndë. Argjendari bie në gjunjë dhe e mbështet ballin mbi këpucët e Kamilës.

KAMILA: (*sallës, me zë të fortë*) Ai zotëron artin për ta dredhur. Fjala bashkëpunëtor do të ishte me e saktë se fjala spiun. Sepse përveçse ka kallzuar të tjerët, ai ka marrë pjesë edhe në falsifikimin e pasaportave të çifutëve, udhëtimi të cilëve përfundoi në kampin Dransi. (*me këmbën e saj ajo e detyron Argjendarin ta kthejë fytyrën nga salla. Zonja Helmirë e ndriçon nga tryeza*) Mirë, pra, Norbert Kombreshu, tregoju atyre, si u bënë padronë të Kafesë së Madhe prindërit e tu, që ishin trokalarë. Mos kanë ardhur viktimat e tua pikërisht këtu, në këtë vend ku ndodhemi, në këtë tryezë... (*ajo tregon me gisht tryezën*)... për të lënë paratë e tyre në këmbim të një pasaporte, që do t'u shpëtonte jetën?

ARGJENDARI: (*duke iu lutur dhimbshëm*) Hesht, hesht... Kamilë... Kam frikë.

Gruaja Leopard, e lebetitur, lëshon krahët përgjatë trupit. Djaloshi, me kokën midis duarve, dënes në kabinën telefonike. Kamerierit i bie përparsja përtokë.

AKTI IV

Dhoma është zhytur në një gjysmë errësirë. Mbi tryezë luhatet flaka e qiririt, gati në të shuar. Zonja Helmirë, me bustin shtrirë përgjatë tryzës, gërhet. Fytyra e saj, e zënë krejt nga kapelja, nuk shihet fare. Në qoshen ku pak më parë qëndronte Kamila, Gruaja Leopard, e ulur drejt e në dysheme, flen me kokën e anuar nga supi. Ajo është mbuluar me mushamanë ngjyrë vjollcë të Zonjës Helmirë. Kabina telefonike është bosh. Kamerieri flen mbi shkallare, i mbledhur kruspull. Dëgjohen gërhimat e tij. Përtokë dergjen dy shishe shampanje bosh dhe një kovë shampanje e vendosur mbi pinetë. Brenda saj gjendet një shishe, së cilës i është hequr tapa. Hapet dera e nevojtores. Shfaqet Argjendari duke mbërthyer pantallonat dhe pas tij Kamila. Topuzi i flokeve të saj është shprishur.

ARGJENDARI: Të gjithë janë zgërlaqur. *(ai hedh një vështrim te kabina telefonike)*
Duhet të jetë ngjitur të flejë në ndenjësë, ai tuhafi. Ëndërrojmë të ndryshojmë botën, por gjërat e forta na vrasin kurrizin.

KAMILA: Më mbush një gotë, e kam gojën pleh...

Argjendari shkon drejt tryezës duke vërshtëllyer dhe merr dy gota, ato që i zë dora. Pastaj përkulet pranë kovës për t'i mbushur. Të parën ia zgjat Kamilës, që ndodhet në këmbë, pranë tij.

ARGJENDARI: Çfarë goje që ke, moj sheqerkë, oh, çfarë goje. Të hatashme, të hatashme!

KAMILA: Motra ime thotë se sperma ka një erë, por unë nuk ndiej asgjë.

ARGJENDARI: Me gjithë ato gjëra që merr ti, moj sheqerkë, s'ka si të ndiesh gjë.

KAMILA: Gabohesh Kambershu, përveç shampanjës, unë nuk marr asgjë tjetër.

ARGJENDARI: Pra nuk ka për ty ndonjë kënaqësi të vogël, kalimthi?

KAMILA: Po si jo: kënaqësia për të pasur miq. *(ajo përkëdhel gjerdanin)* Vërtet është imi ky?

ARGJENDARI: Në një farë mënyre. Përderisa ti më përket mua, atëhere edhe gjerdani më përket mua. Punët nuk rregullohen kështu. (*ai ia bën me shenjë të ulet. Kamila ulet galiç.*) Ajo nuk do të marrë kurrë tridhjetë mijë franga, mos e diskuto! Ma shih këtë lopën, edhe këtë tjetrën; të zgërlaqura, dhe gërhasin, dhe u del pija nëpër gjumë... Ah fatmirësisht unë të kam ty, shqerrka ime!

KAMILA: (*duke rënë në gjunjë*) Atëhere ajo puna e detit ishte një lojë.

ARGJENDARI: Oh, të lutem, t'i lemë çilimllëqet midis nesh! Pastaj, deti, do të fitosh ndonjë gjë po të shohësh detin?

KAMILA: Asgjë

ARGJENDARI: E sheh? Jo, jo, ne do të shkojmë rehat rehat në shtëpi, marrim një sy gjumë, që nesër t'ia nisim prapë me shampanjë. Dhe nesër, e di çfarë? Thuaj, moj shqerrkë, e di? Me të rënë ora dymbëdhjete e natës do ti bëj një telefon shitësit të midhjeve te Kupola të na dërgojë një pjatancë të madhe me fruta deti, e kështu zëre se kemi shkuar në det... Po ç'ke qe i përplas qepallat? Eshtë tik apo çfarë?

KAMILA: Më ka filluar prej gati dhjetë ditësh, kur po e bëja me një tip. Atëherë pata një vegim dhe që nga ai çast, sa herë që ngjitem lart me ndonjë klient me shfaqen vegime.

ARGJENDARI: Po tani pse të shfaqen?

KAMILA: Sepse mbajta në gojë një kërmill.

ARGJENDARI: (*duke zbratur gotën e tij*) Mirë, pra, meqë po e kthen muhabetin kështu... Çfarë vegimi po shikon tani?

KAMILA: (*pasi kthen një gllënjë shampanjë, vështron sallën me fytyrën e gritur lart*) Një qen dhe një qene majë një muri prej gurësh të thatë, siç kam parë në fshat kur isha fëmijë... Të ngjitur dhe duke dihatur nën një diell përvëlues... Kur i mbyll sytë... (*ajo mbyll sytë*) ... kafshët duken të mëdha. Në të kundërt... (*ajo hap sytë*) ... sapo i hap sytë, kafshët zvogëlohen, kthehen në dy miza dheu, të përfshira në një veprimtari të ethshme. (*ajo pi një gllënjë tjetër shampanjë*) Unë i kam vrojtuar shumë mizat e dheut në fshat. Kur nuk di asgjë për to, kujton se ato lëvizin kot. Ashtu, për qejf, ose ngaqë s'kanë ndonjë gjë tjetër më të mirë për të bërë... Por kur i vështron, dhe unë i kam vështruar gjatë mizat e dheut në fshat, me orë, me muaj, me vite, - të bie në sy se ato nuk bëjnë kot as gjestin më të vogël... Nëse mund të themi që mizat e dheut bëjnë

gjeste... Por meqë ato më shtyjnë të mendoj për ne... Ama, mizat e dheut i gjenden njëra - tjetrës. *(duke bërtitur)* Mizat e dheut i gjenden njëra - tjetrës.

Kamila e lëshon veten të bjere përpara dhe balli i saj përplasat fort në anën e kovës së shampanjës. Gota i shpëton nga dora dhe i thyhet. Vijnë dritat. Argjendari, duke e ndihmuar Kamilën, e cila mban kokën me duar, mbyllet bashkë me të në WC.

ZONJA HELMIRË: *(e zgjuar me dridhmë)* Sa të jetë ora? *(ajo heq kapelen, e vendos mbi qiririn, që harxhohet krejt.)* Tërë natën duke pirë... i kam premtuar vajzës të shkoj ta shoh sot... Do të shkoj në vizitat e mesditës... *(ajo fërkon sytë, i zgurdullon, vështron rreth vetes dhe ngrihet duke u mbështetur te tryeza. Shkon deri te Gruaja Leopard, që është kruspullosur nën mushama. E tund butësisht.)* Ngrihuni vogëlushe, kështu, mbi dysHEME, do të sëmureni.

Pushim. Gruaja Leopard nxjerr kokën nga mushamaja. Ajo vështron rreth vetes e shashtisur dhe shpërthen në lotë. Zonja Helmirë e ndihmon të ngrihet.

GRUAJA LEOPARD: Kam ftohtë.

ZONJA HELMIRË: *(duke hequr mantonë)* Merreni, do t'ju mbajë ngrohtë. *(ajo e ndihmon Gruan Leopard të veshë mantonë)*

GRUAJA LEOPARD: *(duke u dridhur)* Kam ftohtë.

ZONJA HELMIRË: *(duke e çuar te karrigja, ku ajo ulet)* Dritat erdhën, e shihni? Do të ngjitem lart, t'u them të na bëjnë kafe. Një kafe të mirë, të ngrohtë, në një gotë të madhe.

Gruaja Leopard dridhet, qëndron ulur dhe kafshon fundin e gërshetit. Zonja Helmirë shkon drejt shkallëve.

ZONJA HELMIRË: *(duke tundur Kamerierin)* Ngrihu, Luis, festa mbaroi!

KAMERIERI: *(i shashtisur)* Po, si gjithmonë. Ku janë të tjerët?

Shfaqet djaloshi, me flokë të kreshpëruar.

DJALOSHI: *(duke ndaluar te shkallarja e dytë)* Po zbardh. Do të mund të largohemi nga punishtja e lëngut të mollëve.

ZONJA HELMIRË: Është e vërtetë, të ngjitemi lart, atje do ta pijmë kafën më rehat.

GRUAJA LEOPARD: *(duke u ngritur)* Ku është çanta ime?

ZONJA HELMIRË: Duhet të jetë në nevojtoje. Mos kini merak, do t'jua gjej menjëherë.

Të katër ngjisin shkallët. Pushim. Dera e WC-së hapet dhe shfaqet koka e Argjendarit.

ARGJENDARI: Ata u ngjiten lart... Eja, shqerrka ime... Nuk je dhe aq e prishur sa kujton, pas dy ditësh s'do të kesh më asnjë shenjë. Era e detit i shëron të gjitha, do ta shohësh... *(ai e hap derën krejt, shfaqet Kamila me ballin e enjtur.)* Di një hotel në Truvil: Hoteli Flober. Do të marrim me qera një apartament me pamje nga deti. *(ai e merr Kamilën në krahë, e përqafton dhe të dy kthehen në qendër të dhomës, në heshtje.)* Unë di një strofë të këngës që ti këndoje pak më parë... Vëre kokën këtu, shqerrka ime, askush nuk do të të bëjë më keq. *(Kamila e vë kokën te supi i Argjendarit, i cili më shumë reciton se sa këndon)* A nuk mi fshin tani ata lotë?

Bukuroshet kur qajnë duken keq!
Vër kësulen e bukur me lule
Dhe përparësen e qëndisur me grep
Shko bashkohu me të rinjtë e fshatit
Në fshat ku dashuria të deh sot
Se në vdeksha unë, ti duhet të jetosh...
Dhe pa dashuri nuk jetohet dot!

KAMILA: Bert, je kaq i mirë!

ARGJENDARI: Unë i mirë? Lëri këto, kur ti e di të vërtetën. Madje ti e shpalle publikisht, dhe me aq talent... Askush nuk e besoi me të vërtetë... Unë i mirë?

KAMILA: Kujdesi që tregon për mua, kujdes që askush nuk do ta tregonte për një lavire, i fshin të gjithë çifutët që ti ke dërguar në dhomën e gazit.

ARGJENDARI: Më në fund, do të më përqaftosh?

KAMILA: Së shpejti. Tani për tani ndihem shumë keq, nuk arrij të përzë atë vegimin... Më duket sikur i dëgjoj tek ulërijnë

ARGJENDARI: S'do t'ia nisësh prapë avazit shqerrka ime, rri tani. Ma përmend këtë sa herë që pi! Dhe, tekefundit, kush të ka thënë se ata ulërinin? Një mik që punonte atje si mjek, më ka pohuar se gjithçka bëhej shpejt e shpejt...

KAMILA: S'është e vërtetë. Një vajzë që punon me mua te qoshja, më ka thënë se ata ulërinin.

ARGJENDARI: Nga e di ajo?

KAMILA: Ajo ka qenë në Dahau.

ARGJENDARI: Çifute komuniste? Dhe ç'moshë ka ajo?

KAMILA: Si unë, njëzetë e tre vjeçe.

ARGJENDARI: *(duke ia shkrepur së qeshurës)* Mendo, shqerrka ime, si ka mundësi që ajo të ketë qenë në Dahau, kur është vetëm njëzet e tre vjeçe? Mbase ka vajtur atje për pelegrinazh.

KAMILA: Ajo thotë se edhe unë kam qenë atje, se më ka parë, dhe një ditë mund ta provojë këtë me anë të ca fotografive... Ajo kërkon prova.

ARGJENDARI: Ajo vajzë është e çmendur. *(ngadalë ai fillon ta bëjë Kamilën të kercejë vals)* Nesër më çoj atje, të qeshim pak.

KAMILA: Ti s'ke për ta prekur me dorë, apo jo?

ARGJENDARI: Po bëhesh xheloze?

KAMILA: Një mbeturine krenarie. I kam thënë se ti do të martohesh vërtet me mua...

ARGJENDARI: Atëherë, të pëlqen studioja buzë ujit?

KAMILA: Në rregull.

ARGJENDARI: Ti s'do të çosh atje njeri tjetër veç mashkullit tënd dhe meje?

KAMILA: Beto hem, vetëm ju të dyve.

ARGJENDARI: Nuk do t'i ndërrosh çarçafët pa të urdhëruar unë?

KAMILA: Kurrë.

ARGJENDARI: Ti je plehra më e shkëlqyer që kam takuar ndonjëherë. Imorale deri në majë të thonjve, një lloj pusi pa fund që kullon zvetënim... Hapu! *(Kamila hap këmbët. Argjendari fut dorën nën fustanin e saj)* Për më tepër është e squllur si qene!

KAMILA: Mbetjet e klientëve...

ARGJENDARI: *(duke tërhequr dorën nga nën fustani)* Merri erë!

KAMILA: *(duke kthyer fytyrën)* Jo!

ARGJENDARI: Çfarë! Nuk të pëlqen era jote?

KAMILA: Nuk është era ime.

ARGJENDARI: Megjithatë, merri erë!

KAMILA: Jo!

ARGJENDARI: Si duhet të ta kërkoj këtë?

KAMILA: Nesër ma kërko sa herë të duash, por jo tani. Ka çaste kur kam përshtypjen sikur të gjithë gjirizet e qytetit me ngrihen deri në grykë... Kam gromësira minjsh, gjaku të mpiksur, krodhash, sperme, tmerri... Nesër... vegimi përzihet me zëra, degjo...

DJALOSHI: (zë) Diku, larg, na ishte një lumë gjaku i rrëmbyer. Si një kalë që vrapon me të katra... Tutje kuqëlon krifa e tij. Muzika e thundrave të tij është e shkëlqyer! Ura e kështjellës ngrihet... Të këqinj të mbërthehen për fyti. I vënë të mësojnë se ç' do të thotë të rraskapitesh në punë.

GRUAJA LEOPARD: (zë) Zhoanë!

DJALOSHI: (zë) Të mbështjellë me një shkumë të bardhë, ata dergjen mbi shtretër bajgash. Sipër tyre qëndrojnë kafshët, të çmendura nga beteja, u derdhin mbi fytyra fjalë të papastra, disa të fshehta që ata nuk do të kenë kohë t'i zbulojnë...

KAMERIERI: (zë) Kamilë, jam unë, qeni yt i rimishëruar, do të të jem besnik përgjithmonë.

GRUAJA LEOPARD: (zë) Zhoanë!

ZONJA HELMIRË: (zë) Ajo ka parë në ëndërr sikur i binin të gjithë dhëmbët, pastaj i vendoste një nga një në një protezë... Kur u ktheva nga spitali, i vura gjurmashkat e mia mbi tryezë... Dhëmbë, gjurmashka; kjo do të thotë se dikush do të niset...

Pushim. Kamila shkëputet nga Argjendari.

KAMILA: Po ndodh diçka e mrekullueshme... Sikur vegimi hijëzohet, zhduket... E beson ti se kjo është e mundur? Se më në fund unë do të shpëtoj prej tij? Bert, qentë dhe mizat e dheut po ikin... Po tërhiqen. Zërat heshtin... Bota hapet. Bota! Bukur!... Ti më ktheve botën. Dora jote, dora jote... sa e butë që është. Dhe do të të them një të fshehtë, Bert. Unë e dua Bert, unë e dua doçkën tënde të butë prej vrasësi... Ajo e sjell në qejf shqerrkën tënde... Ulu! Atje. Dhe tani mbylli sytë. Mbylli mirë dhe hapi vetëm kur të të jap shenjë unë... Do të ndodhë diçka e mrekullueshme.

ARGJENDARI: Ç'lëkurë të mirë që ke: duken engjëjt.

Pushim. Kamila hap çantën e dorës, prej nga nxjerr një revolver. Buçet një shkrepje. Argjendari shembet, i goditur në mes të ballit. Dëgjohet një kalërim dhe të shkallët shfaqen shpejt zonja Helmirë, Kamerieri, Djaloshi dhe Gruaja Leopard.

FUND